



SHOQËRIA CIVILE NË PARANDALIMIN DHE KUNDËRSHTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË SHQIPËRI



This project is funded by
the European Union



SHËNIM: Ky botim është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Publikuar nga: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Autore: Iris Aliaj

SHOQËRIA CIVILE NË PARANDALIMIN DHE KUNDËRSHTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË SHQIPËRI

- Raport Hartëzimi -

PARATHËNIE

Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor gjithnjë e më shumë po inkurajohen për t'u angazhuar në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (P/LKEDH/LKEDH), duke u fokusuar kryesisht në luftimin e radikalizmit që çon në dhunë, por edhe në çështje më të gjera që lidhen me promovimin e tolerancës, parandalimin e gjuhës së urrejtjes, pajtimin dhe edukimin qytetar. Programimi efektiv në P/LKEDH në Ballkanin Perëndimor kërkon zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve ekzistues të aktorëve lokalë për të ofruar programet P/LKEDH/LKEDH në nivel të komunitetit.

Për këtë arsye, një konsorcium i përbërë nga gjashtë OSHC nga Ballkani Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë¹, ish - Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, dhe Serbi) kanë kryer një hartëzim të aktorëve më të rëndësishëm në zbatimin e projekteve të fushës së P/LKEDH/LKEDH. Ky publikim përmban gjetjet e hulumtimit mbi OShC-të e identifikuar në nivel kombëtar, organizatat me bazë fetare (OBF) dhe grupet e komunitetit lokal, formale dhe joformale, që punojnë në fushën e P/LKEDH/LKEDH në Shqipëri, si dhe analizon cilësinë dhe potencialet e marrëdhënieve të tyre me aktorët kyç lokalë, kombëtarë dhe rajonalë nga sektori publik, i shoqërisë civile dhe i biznesit. Hartëzimi është bërë duke përdorur një metodologji të vetme të përmbledhur, të shpërndarë nga secila organizatë partnere.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) angazhoi Av. Iris Aliaj si ekspertin përgjegjës për kryerjen e procesit të hartëzimit në nivel kombëtar në Shqipëri. Procesi i hartëzimit përfshiu 55 OSHC dhe OBF që veprojnë si në nivel kombëtar dhe lokal në fushën e LKEDH dhe/ose P/LKEDH. Metodologjia e përdorur për të kryer me sukses procesin e hartëzimit përfshiu përdorimin e pyetësorëve të strukturuar, takimet me palët e interesuara, hulumtimin shkencor, pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme të organizuara nga OSHC-të apo donatorë/partnerë që veprojnë në këtë fushë në Shqipëri, etj.

Ky aktivitet është pjesë e projektit rajonal “Komunitetet të parat: krijimi i rrjetit të organizatave të shoqërisë civile për parandalimin dhe përballimin e ekstremizmit të dhunshëm - nga parandalimi në riintegrim”, zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (Shqipëri), Hope and Homes for Children (Bosnje dhe Hercegovinë), Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konflikteve (Kosovë), Forum MNE (Mali i Zi), Centre for Common Ground (Maqedoni) dhe Qendra Kulturore DamaD (Serbi) dhe mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian përmes Programit të Shoqërisë Civile dhe Medias 2016- 2017, Konsolidimi i Rrjeteve Tematike Rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile.

¹ Ky përcaktim është pa paragjykimë ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe Opininionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

• PARATHËNIE	4
• I. Arritje. Vështrim i risqeve: informacion mbi rrezikun aktual të ekstremizmit të dhunshëm në vend, parë kryesisht nga këndvështrimi i OSHC-ve	6
• II. Mbledhja e Informacionit. Metodologjia, Burimet, Mjetet	13
• III. Seksioni Analitik/Përshkrues	14
• IV. Në cilat fusha të parandalimit dhe luftës ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, OSHC-të janë më aktive?	14
• V. Gjetjet	15
• VI. Arritje dhe praktika të mira	18
• VII. Cilat janë boshllëqet e identifikuar në lidhje me përfshirjen e OSHC-ve drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në çështje të parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm?	19
• VIII. Cilat janë pengesat e bashkëpunimit mes OSHC-ve dhe qeverisë në kontributin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në P/LKEDH/LKEDH	25
• IX. Vlerësim paraprak i pikave të forta dhe mundësive të OSHC-ve lokale dhe grupeve formale dhe joformale të komunitetit në zhvillimin e programeve për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit që të çon në terrorizëm dhe çështje të politikave kundër këtyre fenomeneve	26
• X. Analiza paraprake e dobësive, sfidave dhe pengesave me të cilat ballafaqohen OSHC -të lokale dhe grupet formale dhe joformale të komunitetit për zhvillimin e programeve P / LKEDH dhe çështje të lidhura me politikën	31

LISTA E SHKURTIMEVE

Organizatave e Shoqërisë Civile - OSHC

Vendimin e Këshillit të Ministrave -VKM

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm - QKEDH

Ministria e Brendshme - MB

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - MSHMS

Ekstremizmi i Dhunshëm-EDH

Luftimi Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm - LKEDH

Parandalimi dhe Luftimi Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm - P/LKEDH

Komiteti Shqiptar i Helsinkit – KShH

Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës - ARCT

I. Arritjet. Vështrim i risqeve: informacion mbi rrezikun aktual të ekstremizmit të dhunshëm në vend, parë kryesisht nga këndvështrimi i OSHC-ve.

Shoqëria civile në Shqipëri njeh zhvillimet ligjore, politike dhe institucionale për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Organizata të ndryshme të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë në publikimet e tyre vlerësojnë progresin e bërë në zbatim të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. (Nëntor 2015)².

Kështu, mund të përmendim disa arritje të rëndësishme në fushën e parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm si përmirësimet e kuadrit ligjor, në mënyrë të veçantë në legjislacionin penal, miratimin e Strategjisë Kombëtare KEDH, ngritjen e zyrës së Koordinatorit Kombëtar KEDH dhe ngritjen e një Qendre Koordinimi KEDH, ndërmarrjen nga qeveria shqiptare të disa reformave institucionale, si dhe kontributin e OSHC-ve në nivel kombëtar dhe lokal në zbatimin e projekteve për parandalimin dhe përballimin e këtyre fenomeneve. Gjithashtu, një nga aspektet pozitive është se, pavarësisht programit nëse është Program ndërhyrjeje, Program Parandalimi ose Program rehabilitimi, ka një larmishmëri të iniciativave dhe aktiviteteve brenda programit. Fokusi tematik i organizatave të shoqërisë civile është zgjeruar, duke përfshirë tematika të ndryshme si: ndërmarrjen e iniciativave konkrete të autoriteteve lokale, shkollave, familjeve, të rinjve për të punuar në adresimin e faktorëve që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm, ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme, pilotimin e Shkollës Qendër-Komunitare, forcimin e policimit në Komunitet, rritjen e nivelit të bashkëpunimit të organizatave të shoqërisë civile mes tyre dhe me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, fuqizimin e partnerëve lokalë, zhvillimin e hulumtimit në nivel qendror dhe lokal, etj. Puna e OSHCOSHHC-ve që punojnë në këtë fushë ka dhënë rezultate reale. Kështu, rritja e informimit mbi vlerat e çdo besimi dhe komuniteti, ulja e incidenteve fetare, pjesëmarrja e komuniteteve fetare, OSHC-ve, institucioneve vendore në këshillat e sigurisë në nivel vendor, edukimi me mesazhe të kundërta me ato EDH dhe radikalizmit duke përdorur median sociale dhe mediat tradicionale, puna e aktorëve lokalë për të adresuar faktorët shtytës dhe tërheqës të ekstremizmit të dhunshëm, forcimi i kapaciteteve të aktorëve përgjegjës në nivel lokal, etj., janë disa nga rezultatet konkrete.

Në Dhjetor të 2017, me VKM nr. 737, datë 13.12.2017 u krijua Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), me seli në mjediset e ish- Ministrisë së Integritimit Evropian³ dhe që vepron nën kompetencat e

² Gjergji Vurmo & Enis Sulstarova, IDM, "Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri", Një vlerësim kombëtar i shkaqeve, formave dhe kërcënimeve. Ekipi Hulumtues i IDM: Gjergji Vurmo, Hulumtues Kryesor, Enis Sulstarova, Hulumtues, Aleka Papa, Hulumtues, Dalina Jashari, Hulumtuese, Romario Shehu, Hulumtuese. Tiranë, Tetor 2018., f. 11. Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit "Përforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm", mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës Amerikane në Tiranë

³ Me adresë: Rr. "Papa Gjon Palë II", Nr. 3, Kati 2, E-mail: info@cve.gov.al / ëeb: ëëë.cve.gov.al.

Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Misioni i Qendrës Koordinuese është të zhvillojë kapacitetet e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në veprime që luftojnë ekstremizmin e dhunshëm, për ruajtjen dhe promovimin e vlerave të tolerancës, harmonisë fetare dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, promovimin e sundimit të ligjit dhe procesit të demokratizimit dhe mbrojtjen e komunitetit shqiptar nga ekstremizmi i dhunshëm⁴. Në vitin 2017, Kryeministri caktoi Drejtorin e QKEDH, z. Agron Sojati, për të koordinuar parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, njëherazi edhe në pozicionin e Koordinatorit Kombëtar për kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Qendra ka filluar funksionimin në muajin Qershor 2018, dhe në muajin Dhjetor 2018 funksionon me 90% të kapaciteteve të burimeve njerëzore të saj.⁵ Por, pavarësisht këtij progresi, disa nga risqet lidhur me EDH në vend, parë më së shumti nga këndvështrimi i OSHC-ve janë:

Së pari, ka një nivel të pamjaftueshëm informacioni nga komuniteti për kuptimin e fenomenit, faktorëve, të grupeve në risk, politikave dhe legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që të çon në terrorizëm, si edhe për strukturat përgjegjëse dhe rolin e tyre në zbatim të këtyre politikave dhe ligjeve. Për të rritur informacionin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me këtë fenomen, po punohet sidomos nga OSHC-të lokale, në kuadrin e projekteve të mbështetura kryesisht nga grante të vogla, që nuk arrijnë të mbulojnë të gjithë hapësirën gjeografike në vend apo zonat Hotspot/problematike. Si të tilla, rezultatet e punës së tyre jo gjithmonë janë të qëndrueshme në kohë dhe rezultate.

Së dyti, Rreziku nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm në vend është real.

“Afërsisht 150 shtetas shqiptarë kanë shkuar në Siri dhe Irak me qëllim angazhimit në ‘Luftën e Shenjtë’ dhe ndihmën ndaj grupeve të armatosura atje, ndër të cilët 31 fëmijë dhe 13 gra”⁶.

Individë të ndryshëm janë dënuar nga gjykata e Krimeve të Rënda⁷ për veprat penale: “Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave terroriste

⁴<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%20225/VKM%20nr.%20737,%20date%2013.12.2017.pdf>

⁵ Zj. Klejda Ngjela, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)

⁶ Sandër Simoni, Manjola Xhaxho, Arbër Lloshi, Raport “EKSTREMIZMI, RADIKALIZMI DHE TERRORIZMI”, Tirana 2018, p.14. Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Bashkinë Roskovec dhe zonat rurale në këtë bashki”, i zbatuar nga Qendra “Gruaja, Komuniteti, Mjedisi” në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), mbështetur financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti Holandez i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe shoqata “Together for Life”, Shqipëri.

⁷ Sandër Simoni, Manjola Xhaxho, Arbër Lloshi, Raport “EKSTREMIZMI, RADIKALIZMI DHE TERRORIZMI”, Tirana 2018, p.15-16. Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Bashkinë Roskovec dhe zonat rurale në këtë bashki”, i zbatuar nga Qendra “Gruaja, Komuniteti, Mjedisi” në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), mbështetur financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti Holandez i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe shoqata “Together for Life”, Shqipëri.

“, neni 232 e 25 i KP, “Nxitja urrejtjes ose grindjeve”, neni 265 e 25 i KP si dhe veprën penale të “Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose të financimit të terrorizmit” , neni 231 e 25 e KP⁸, “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 265/a/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal⁹, etj.

Organizatata e shoqërisë civile në Shqipëri mendojnë se rreziku i ekstremizmit të dhunshëm në vend është real dhe prezent, sa kohë që ekzistojnë faktorët që e ushqejnë këtë fenomen, si faktorët shoqërorë, individualë, të sjelljes, faktorë që lidhen me vulnerabilitetin e grupeve të caktuara, faktorë kontribues si papunësia, lidhja e dobët e individit me shtetin, niveli i ulët i informacionit mbi fenomenin në fjalë, përjashtimi nga ndjesia e përkatësisë në një komunitet të caktuar, përhapja e dhunës dhe diskriminimit në shoqëri, etj. Ndërsa vlerësohet se kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, i shkaqeve dhe faktorëve kontribues nga aktorët që punojnë në këtë fushë është rritur,, në nivel komuniteti niveli i njohurive ka nevojë të rritet. Në vitin 2015, në një publikim të IDM mbi radikalizmin fetar ndahej mendimi se, “...mungesa e shoqërisë civile (në zonat e largëta) apo e veprimeve konkrete për problemet e varfërisë, rinisë dhe komunitetit ka lënë një boshllëk të madh dhe ka krijuar hapësira të mjaftueshme për radikalizmin (fetar)”¹⁰. Sot, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë në nivel qendror dhe vendor e kanë të qartë se adresimi i problemeve të varfërisë dhe vulnerabilitetit, papunësisë, etj. përbën një kontribut për reduktimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

“...prania e ideologjive fetare ekstremiste dhe individëve të tillë është konfirmuar”¹¹

“Niveli i demokracisë në vend dhe niveli i deritanishëm i zhvillimit socio-ekonomik ngre shqetësime se ata, në kombinim me faktorë të tjerë, mund të kërcënojnë grupe të veçanta në shoqëri nëpërmjet fuqisë së manipulimit të ideologjive ekstremiste”.¹²

” Prania e ekstremistëve fetarë dhe individëve që ushtrojnë presion ndaj besimtarëve fetarë për t’u bashkuar kauzave ekstremiste konfirmohet në komunat që më parë kanë qenë të panjohura si hotspots/ “pika të nxehta” nga komuniteti

⁸ Vendimi nr. 58 datë 03.05.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁹ Vendimi nr. 46 datë 04.05.2017 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

¹⁰ <http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2017/02/RadikalizmiFetar-ëebOK2.pdf>

¹¹ Gjergji Vurmo & Enis Sulstarova, IDM, „Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri“, Një vlerësim kombëtar i shkaqeve, formave dhe kërcënimeve. Ekipi Hulumtues i IDM: Gjergji Vurmo, Hulumtues Kryesor, Enis Sulstarova, Hulumtues, Aleka Papa, Hulumtues, Dalina Jashari, Hulumtuese, Romario Shehu, Hulumtuese. Tiranë, Tetor 2018,, f.11. Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit „Përforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm“, mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës Amerikane në Tiranë. <http://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>

¹² Gjergji Vurmo & Enis Sulstarova, IDM, “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri“, Një vlerësim kombëtar i shkaqeve, formave dhe kërcënimeve. Ekipi Hulumtues i IDM: Gjergji Vurmo, Hulumtues Kryesor, Enis Sulstarova, Hulumtues, Aleka Papa, Hulumtues, Dalina Jashari, Hulumtuese, Romario Shehu, Hulumtuese. Tiranë, Tetor 2018,, f. 11. Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Përforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm”, mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës Amerikane në Tiranë. <http://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>

i aktorëve që janë aktivë në fushën e P / LKEDH dhe praktikuesit në Shqipëri”¹³

Së treti, ndërkohë që rreziku i ekstremizmit të dhunshëm është real, strukturat në përgjigje të këtij fenomeni janë të kufizuara ose të krijuara rishtazi, disa prej tyre janë në procesin e ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve të tyre, me një bashkëpunim të brishtë me institucionet vendore, organizatat e shoqërisë civile që punojnë në nivel vendor dhe kombëtar dhe aktorë të tjerë.

Strukturat në nivel lokal që trajtojnë këtë fenomen nuk janë ngritur në të gjitha bashkitë e vendit dhe në bashkitë pranë të cilave këto struktura aktualisht janë ngritur, nevojat për forcimin e kapaciteteve janë të mëdha. Ky fakt është shqetësues nëse konsiderojmë se, në disa bashki të vendit, organizatat e shoqërisë civile janë të kufizuara në numër dhe në disa raste edhe në objektin e veprimtarisë.

Por, edhe në bashkitë ku organizatat e shoqërisë civile janë aktive, bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve të arsimit dhe edukimit, atyre fetare dhe njësisë të qeverisjes vendore është fokusuar më shumë në realizimin e fushatave të sensibilizimit dhe informimit dhe më pak në identifikimin e problematikave, rasteve konkrete, si edhe adresimin e tyre.

Ky fakt rezulton edhe nga të dhënat e studimeve të fundit mbi rolin e aktorëve në parandalimin e ekstremizmit. “Tre aktorët kryesorë që më së shpeshti sugjerohen nga shqiptarët e anketuar (Tabela 6: Opinione të respondentëve për aktorët më të rëndësishëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri) përfshijnë liderë të lartë të bashkësive fetare (41%), media (37.3% dhe klerikët fetarë vendas (33%). Këtij grupi aktorësh i kushtohet vëmendje nga qeveria qendrore (26%) dhe shoqëria civile (25.8%)”¹⁴.

Së katërti, mjetet e përdorura për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm ose luftimin e tij kanë nevojë të përshtaten sipas specifikave të grupeve të synuara dhe për rrjedhojë të kenë efektivitetin e duhur. Megjithatë, nuk mungojnë shembujt pozitivë.

Një shembull është se sa media sociale arrin të përcjellë mesazhin në grupe të

¹³ Gjergji Vurmo & Enis Sulstarova, IDM, “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”, Një vlerësim kombëtar i shkaqeve, formave dhe kërcënimeve. Ekipi Hulamtues i IDM: Gjergji Vurmo, Hulamtues Kryesor, Enis Sulstarova, Hulamtues, Aleka Papa, Hulamtues, Dalina Jashari, Hulamtuese, Romario Shehu, Hulamtuese. Tiranë, Tetor 2018, f. 11. Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Përforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm”, mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës Amerikane në Tiranë <http://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>

¹⁴ Gjergji Vurmo & Enis Sulstarova, IDM, “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”, Një vlerësim kombëtar i shkaqeve, formave dhe kërcënimeve. Ekipi Hulamtues i IDM: Gjergji Vurmo, Hulamtues Kryesor, Enis Sulstarova, Hulamtues, Aleka Papa, Hulamtues, Dalina Jashari, Hulamtuese, Romario Shehu, Hulamtuese. Tiranë, Tetor 2018, f. 114. Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Përforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm”, mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës Amerikane në Tiranë. <http://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>

ndryshme të synuara. Përdorimi i mediave sociale nga aktorët që punojnë në këtë fushë nevojitet të jetë më strategjik dhe i orientuar në metodologji për grupet e ndryshme më vulnerable, të rinjtë, të papunët, gratë, individët e kthyer, etj. Vihet re një komunikim përshkrues i aktivitetit të organizatave të shoqërisë civile, i fokusuar sidomos tek aktivitetet e organizuara në kuadrin e zbatimit të projekteve të ndryshme dhe më pak një komunikim përmbajtësor me grupet e ndryshme të komunitetit, i cili të ndalet tek fenomeni, shkaqet e tij, faktorët nxitës në grupe të ndryshme, rezultatet e arritura, apo mësimet të nxjerra nga lufta ndaj tij. Aktorët nevojitet të konsiderojnë më shumë sa këto grupe të veçanta, si komuniteti në zonat rurale, individët me aftësi të kufizuara, etj., përdorin median sociale. Ndërkohë, që ekstremistët në Shqipëri kanë përdorur rrjetet sociale si mënyrë rekrutimi. “Zhvillimi i formave të komunikimit social, rrjetet sociale, aksesit i pakufizuar në to janë një mundësi për të rekrutuar të rinjtë. Gjatë një procesi penal të zhvilluar në Gjykatën e Krimeve të Rënda rezultoi se të pandehurit ekstremistë të ideve radikale kishin shumë frekuentues të rregullt në faqen e tyre të web rreth 1500 vetë, shumica e të cilëve ishin të rinj”¹⁵.

Praktikat pozitive nevojiten të ndahen mes të gjithë aktorëve në nivel kombëtar. Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet Qendrës së Koordinimit KEDH, në bashkëpunim me organizatën CIJA dhe me mbështetjen financiare të SH.B.A-së, ka zbatuar një iniciativë të quajtur “Me Shkollat, për Komunitete më të Sigurta”, që synonte ndërgjegjësimin dhe rritjen e njohurive të mësuesve në të gjithë Shqipërinë, mbi rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis të rinjve¹⁶. Kjo iniciativë u përshtat me specifikat e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë.

Së pesti, politikat kombëtare që e adresojnë këtë fenomen nuk janë konsultuar sa duhet në të shkuarën me organizatat e shoqërisë civile dhe nuk janë të buxhetuara mjaftueshëm, duke e vështirësuar zbatimin e objektivave¹⁷ të tyre.

¹⁵ Sandër Simoni, Manjola Xhaxho, Arbër Lloshi, Raport “EKSTREMIZMI, RADIKALIZMI DHE TERRORIZMI”, Tirana 2018, f.18. Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Bashkinë Roskovec dhe zonat rurale në këtë bashki”, i zbatuar nga Qendra “Gruaja, Komuniteti, Mjedi, harmonizuar për zhvillim” në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), mbështetur financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti Holandez i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe Shoqata “Together for Life”, Shqipëri.

¹⁶ Nëpërmjet një seri trajnimesh për trajnerë, u arrit të ndërgjegjësoheshin 28 000 mësues në të gjithë vendin, aktivitet që u realizua më 12 Janar 2018.

¹⁷ Strategjia Kombëtare ka katër objektiva strategjike që integrohen në misionin e saj kryesor për ndërtimin e kapaciteteve të përfshirjes së disa aktorëve, për të trajtuar në mënyrë efektive kushtet që çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm. Në përputhje me misionin e saj, masat e propozuara sipas Strategjisë Kombëtare janë si vijon:

- Të forcohet koordinimi, bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, agjencitë qeveritare, organizatat joqeveritare, sektorin privat, bashkësitë fetare dhe mediat, në përcaktimin dhe zbatimin e masave efektive të CVE;
- Të inkurajohen hulumtimet lokale për të kuptuar më mirë kushtet, faktorët dhe stimujt që nxisin ekstremizmin dhe radikalizmin e dhunshëm, si dhe nivelet e tanishme të rezistencës në komunitet ndaj ekstremizmit të dhunshëm;
- Përforcimi i rezistencës së komunitetit dhe tkurrja e shkaqeve të radikalizimit radikal dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet politikave të arsimit dhe punësimit në komunitet;
- Reduktimi i ndikimit të propagandës së dhunshme të ekstremizmit dhe rekrutimit online, duke shfrytëzuar mediat sociale për dizajnimin dhe transmetimin e mesazheve pozitive alternative.

Shiko http://ëëë.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf

“Në vitin 2015 u miratua Strategjia Kombëtare Ndër sektoriale dhe Plani i Veprimit për Trajtimin e cila zbaton një qasje parandaluese ndaj ekstremizmit të dhunshëm duke identifikuar komunitetet në rrezik të rënies pre e radikalizimit dhe duke përdorur mjete si arsimit dhe punësimi për të penguar përpjekjet nga grupe të ndryshme për rekrutim. Përveç kësaj, strategjia identifikon bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet agjencive shtetërore të identifikuar më sipër si dhe organizatave joqeveritare, sektorit privat, bashkësive fetare dhe medias si një qasje për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm brenda dhe jashtë vendit”¹⁸.

“Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit (2015 – 2020) synojnë të ndjekin të ashtuquajturën “qasje holistike”. Sa i përket institucioneve qeveritare, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes parashikohen të jenë kontributorët kryesorë dhe të luajnë një rol lehtësues në zbatimin e suksesshëm të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit”.¹⁹ Duke njohur sa më sipër, nevojitet të buxhetohet Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë Kombëtare, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete. Parandalimi i fenomenit të EDH dhe lufta ndaj këtij fenomeni, si edhe masat e nevojshme nuk janë integruar sa duhet në politikat dhe planet e veprimit në nivelin e ministrive përgjegjëse dhe në rastet kur integrimi është i mirë, buxhetimi i tyre është i pamjaftueshëm.

Mundësitë për këtë integrim nga ministrinë përgjegjëse janë të ndryshme. Qendra e Koordinimit KEDH ka krijuar pemën e kontakteve në nivel qendror dhe vendor, të të gjitha ministrive të linjës dhe aktorëve të tjerë relevantë. Lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (më parë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë), zbatimi efektiv i strategjive të punësimit është i një rëndësie të lartë. Ky institucion është në proces zbatimi të Strategjisë Kombëtare për Aftësitë dhe Punësimin (2014-2020) në Shqipëri, ku identifikimi i përfshirjes sociale është një nga objektivat kryesore të saj. Gjithashtu, Shërbimi Kombëtar i Punësimit synon të promovojë politika dhe programe të përmirësuara dhe të diversifikuara të tregut aktiv të punës që do të vihen në dispozicion të grupeve të cënueshme në këto fusha.

Ekziston nevoja që bashkëpunimi midis ekspertëve të mirëqenies sociale dhe profesionistëve të shëndetit mendor të shndërrohet në prioritet, për të siguruar mbështetje të mjaftueshme dhe vlefshmëri të shërbimeve. Përfshirja e MSHMS nëpërmjet ndihmës ekonomike sipas studimeve të kryera nga Banka Botërore, rrit nivelin e jetesës veçanërisht për grupet vulnerabël, përfshirë këtu për ish

¹⁸ Fjala e Zv. Ministres së Brendshme Romina Kukos në Konferencën Rajonale kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, <http://www.mb.gov.al/2018/06/04/konferenca-rajonale-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem-kuko-forcuam-bashkepunimin-me-partneret-strategjike-fbi-e-cia/>

¹⁹ Në lidhje me këtë, shih edhe Fjalimet e Zëvendëskryeministrit Z. Niko Peleshi dhe Zëvendës Ministres së Brendshme, Znj. Romina Kukos në Konferencën Rajonale Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, të mbajtur më 4 qershor 2018, <https://kryeministria.al/newsroom/angazhim-maksimal-ne-luften-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem/> dhe <http://www.mb.gov.al/en/2018/06/04/konferenca-rajonale-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem-kuko-forcuam-bashkepunimin-me-partneret-strategjike-fbi-e-cia/>

luftëtarët e rikthyer. Institucionet shtetërore, aktorët jo-shtetërorë, bashkësitë fetare dhe shoqëria civile duhet të koordinojnë përpjekjet e tyre për të vepruar më mirë në fushat e qeverisjes lokale, arsimit, çështjeve sociale dhe rinisë, punësimit, anti diskriminimit etj.²⁰

Lidhur me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm nëpërmjet organizimit të fushatave të ndërmarra për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, përkatësisht me nismën “Shkolla si Qendër Komunitare”. Sipas Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar (2014-2020), është planifikuar të zgjerohet Rrjeti “Shkolla si Qendër Komunitare” në vitet në vijim. Kjo masë do të përmbajë veprimet e mëposhtme:

- Zgjerimi dhe ekspozimi i Rrjetit “Shkolla si qendër e komunitetit” në zonat problematike.
- Forcimi dhe trajnimi i mësuesve për të dalluar dhe për t’iu përgjigjur shenjave të radikalizmit.
- Rritja e mbështetjes shkollore dhe përpjekjeve jashtëshkollore në shkollat e synuara për të parandaluar radikalizmin, duke përfshirë edukimin civil dhe fetar, nismat artistike dhe sportive, klubet e debatit dhe aktivitete të ngjashme që mund të rrisin rezistencën.
- Adresimi i shkaqeve socio-ekonomike që nxisin radikalizmin dhe EDH përmes ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, si dhe shërbimeve të punësimit.

Lidhur me Ministrinë e Brendshme, “Policimi në Komunitet” ka qenë një mjet i përdorur. Si pjesë e strategjisë së saj të mëparshme shtatëvjeçare (2007-2013), Policia e Shtetit Shqiptar përfshiu modelin e “policimit në komunitet” që do të zbatohet në të gjithë vendin. Në këtë kuptim, Policia e Shtetit Shqiptar, e varur nga Ministria e Brendshme, ka përgjegjësi të mbikëqyrë procesin e shkëmbimit të informacionit. Kjo qasje pro-aktive dhe bashkëpunuese në zgjidhjen e problemeve, e përqendruar në parandalimin, është veçanërisht e dobishme kur shqyrton kërcënimet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Për më tepër, zgjerimi dhe rritja e kapaciteteve të policimit në komunitet, duke vënë theksin në parandalimin e radikalizmit dhe EDH, do të prioritetizohen nëpërmjet iniciativës së mëposhtme: Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve policore në zonat e synuara.

Në lidhje me komponentët e konsultimit të politikave dhe planeve të veprimit, si dhe buxhetimit të tyre ka hapa premtuese. Nga informacioni zyrtar i marrë nga Qendra e Koordinimit KEDH, mësohet se Plani i Veprimit i Strategjisë po zbërthehet në aktivitete konkrete sektoriale relevante për çdo Ministri të ngarkuar

²⁰ Informacion i marrë nga IOM Albania.

me detyra për zbatim. Këto aktivitete do të buxhetohen, nën ekspertizën e partnerëve ndërkombëtarë, si dhe do të ndahen me aktorë të ndryshëm interesi, përfshirë organizatat e shoqërisë civile.

Së gjashti, faktorët kontribues të EDH apo radikalizmit në Shqipëri përfshijnë jo thjesht faktorë ideologjikë, por më së shumti ata socialë dhe ekonomikë. Kështu që mundësitë e kufizuara për adresimin e këtyre faktorëve ndikojnë në efektivitetin e punës për parandalimin dhe luftimin e këtyre fenomeneve.

II. Mbledhja e Informacionit. Metodologjia, Burimet, Mjetet;

Informacioni i mbledhur integron informacionin e marrë nga aktorët si më poshtë:

- a) anëtarë të stafit të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)²¹;
- b) përfaqësues të OSHC-ve lokale ;
- c) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në Shqipëri Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shqipëri, Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Terre Des Hommes;
- d) donatorë ndërkombëtarë që veprojnë në Shqipëri si: Ambasada e SHBA në Shqipëri, BE-ja përmes mbështetjes për OSHC në Shqipëri;

Burimet dhe mjetet për mbledhjen e informacionit janë:

- a) Pyetësorë të strukturuar;
- b) Intervista/komunikime/takime me:
 - I. Përfaqësues të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)²²
 - II. Përfaqësues të Këshillave të Sigurisë në nivel bashkie;
 - III. Përfaqësues të Prezencës së OSBE në Shqipëri;
 - IV. Intervista me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e parandalimit dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm;
- c) Raportet dhe studimet ekzistuese të OSHC-ve, në mënyrë të veçantë raporte të IDM, raporte të Prezencës së OSBE në Shqipëri, publikimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), studime dhe raporte të përgatitura nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile, etj;
- d) Studime, artikuj, publikime të përgatitura nga profesorë, ekspertë, akademikë, etj;

²¹ Feedback nga Zj.Klejda Ngjela, Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit, Edukimit dhe Kërkimit Shkencor.

²² Klejda Ngjela, Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit të Edukimit dhe Kërkimit Shkencor.

d) Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të veçanta që kanë në fokus edukimin e të rinjve apo integrimin e grupeve në nevojë, të cilat mund të jenë të rrezikuara nga ekstremizmi apo rekrutimi i grupeve ekstremiste.

e) Promovimi i politikave publike nëpërmjet lobimit dhe advokacisë (që përfshin identifikimin e problemit dhe nxjerrjen e një sërë rekomandimesh për zonat e ekspozuara ndaj P/LKEDH);

f) Ndjekja, monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të kuadrit ligjor, i dokumenteve strategjike dhe i politikave të tjera të institucioneve shtetërore, me qëllim adresimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, etj”²⁴.

V. Gjetjet:

Së pari, ka rezultuar se, në përqindjen më të lartë të rasteve, OSHC-të janë fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit, sidomos të komunitetit në shkollë, përfshirë komunitetin e nxënësve, prindërve dhe mësuesve në lidhje me këto fenomene.

Së dyti, organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në këshillat e sigurisë në nivel vendor, si p.sh në ato të ngritura në zonat e Cërrikut, Burrelit, Elbasanit, Librazhdit, etj. “Roli i shoqërisë civile në këshillat e sigurisë në nivel vendor është shumë i rëndësishëm në drejtim të identifikimit dhe analizës së nevojave dhe problemeve të komunitetit lokal, forcimit të pjesëmarrjes, transparencës dhe konsultimit. Ato mund të kontribuojnë edhe nëpërmjet hartimit të strategjive dhe planeve të veprimit të sigurisë lokale, OSHC-të gjithashtu mund të kontribuojnë me sugjerime dhe mendime profesionale, ose mund të advokojnë për përmirësimin e tyre, nëse ato janë hartuar tashmë. OSHC-të mund të jenë edhe përçuese të përvojave pozitive të punës dhe të modeleve të këshillave në qytete, bashki apo vende të tjera, por dhe të shërbejnë si ndërmjetëse për rrjetëzimin e këshillave dhe forcimin e bashkëpunimit mes tyre²⁵. Megjithatë, përfshirja më efektive e OSHC-ve në këto këshilla, jo vetëm në zonat e konsideruara si “hot spots”, por në të gjithë territorin e Shqipërisë është e nevojshme.

Së treti, ka rezultuar se organizatat e shoqërisë civile janë angazhuar pak në monitorimin e proceseve gjyqësore ndaj individëve të akuzuar për ekstremizëm të dhunshëm ose terrorizëm. Roli i organizatave të shoqërisë civile në mbikëqyrjen e proceseve hetimore dhe gjyqësore të individëve të akuzuar për ekstremizëm të dhunshëm ose terrorizëm, si dhe në advokimin për zbatimin e masave alternative ndaj tyre nevojitet të rritet, si një komponent i rëndësishëm i rolit të OSHC-ve

²⁴ Izabela Kisis, Dushko Radosavleviq, Jarmila Bujak Stanko, Predrag Petroviq, Pavle Kilibarda, Pavel Domonji, “Ekstremizmi i dhunshëm sfida madhore e kohës sonë MANUAL PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE”, f.31, 2018, http://ëëë.ahc.org.al/ëp-content/uploads/2018/06/Manual_Ekstremizmit-1.pdf

²⁵ Izabela Kisis, Dushko Radosavleviq, Jarmila Bujak Stanko, Predrag Petroviq, Pavle Kilibarda, Pavel Domonji, “Ekstremizmi i dhunshëm sfida madhore e kohës sonë MANUAL PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE”, f.31, 2018, http://ëëë.ahc.org.al/ëp-content/uploads/2018/06/Manual_Ekstremizmit-1.pdf

në raport me punën e institucioneve ligj zbatuese²⁶. Nga ana tjetër, rezultatet e monitorimit mund të ndihmojnë edhe në parandalimin dhe luftimin e radikalizmit dhe EDH.

Së katërti, numri i organizatave që punojnë për ri-integrimin e individëve të kthyer ka nevojë të rritet. Nevojitet të mbulohen më shumë fusha që lidhen me riintegrimin e individëve që kanë rënë pre e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, si dhe nevojiten të bëhen publike dhe të aksesueshme për OSHC-të të dhëna të sakta statistikore lidhur me numrin e shtetasve shqiptarë të rikthyer dhe të mbështetur.

Së pesti, çështjet e radikalizimit në burgje kërkojnë më shumë vëmendje dhe adresim nga organizatat e shoqërisë civile. Numri i organizatave që janë fokusuar në punën në burgje është i kufizuar. Veçojmë Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (ARCT), Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe Qendrën për Korrektim Njerëzor (KRNJ).

Së gjashti, organizatat e shoqërisë civile-relevante të cilat angazhohen në aktivitete që indirekt adresojnë rrënjët e ekstremizmit të dhunshëm janë të shumta në numër. Këtu përfshihen organizatat që punojnë me fuqizimin e të rinjve dhe grave, procesin e rregullt ligjor, anti korrupsionin, angazhimin civil, të drejtat e njeriut, demokracinë, qeverisjen e mirë, formimin profesional, arsimin, ndërtimin e besimit, angazhimin e komunitetit dhe zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve. Qëllimi i këtyre organizatave nuk është të parandalojnë ose të luftojnë ekstremizmin e dhunshëm, por pavarësisht kësaj ato kontribuojnë në reduktimin e këtyre fenomeneve ose ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit kundër EDH . Psh. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem në Tiranë dhe Zyra për Djem dhe Burra në Shkodër²⁷, të cilat punojnë për rehabilitimin e dhunuesve në marrëdhëniet familjare, kontribuojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë për parandalimin e EDH.

Së shtati, ka pasur një rritje të numrit të publikimeve, të përgatitura nga ekspertët në terren, të cilat kanë kontribuar në ngritjen e nivelit të informacionit të komunitetit në lidhje me fenomenin si dhe në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë civile në këtë fushë.²⁸

²⁶ Izabela Kisis, Dushko Radosavleviq, Jarmila Bujak Stanko, Predrag Petroviq, Pavle Kilibarda, Pavel Domonji, "Ekstremizmi i dhunshëm sfida madhore e kohës sonë MANUAL PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE", f.31, 2018, http://ëëë.ahc.org.al/ëp-content/uploads/2018/06/Manual_Ekstremizmit-1.pdf

²⁷ <http://www.cmb.al/>; <http://gruajatekgruaja.com/>

²⁸ Disa nga publikimet janë: KSHH "Ekstremizmi i dhunshëm: një sfidë e madhe e kohës sonë", manual për organizatat e shoqërisë civile, 2018; AHC: "Together kundër ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe radikalizimeve" - një broshurë të përgatitur nga Prof. Dr. Arta Mandro, ekspert; KSHH: Shoqëria civile duke kundërshtuar ekstremizmin e dhunshëm ", një broshurë: Fondacioni IDM dhe Berghof, Redion Qirjazi & Romario Shehu," Perspektivat e komunitetit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri ", Studimi i rastit 4, 2018; Gjergji Vurmo dhe Enis Sulstarova, IDM, "Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri", 2018, OSBE 2014, Parandalimi i terrorizmit dhe përballimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: qasja e policimit në komunitet, Enri Hide, "Vlerësimi i rrezikut të sigurisë sekrete shtetërore për të reaguar; Lindja e një ndikimi në ekstremizëm radikal dhe fetar në Shqipëri ", Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Prof. Dr. Edmond Dragoti dhe Dr. Emanuela Ismaili," Studim Kombëtar mbi trazirat dhe ekstremizmin e dhunshëm në sistemin arsimor shqiptar "Tiranë 2017 me mbështetja e BE-së dhe e Këshillit të Evropës, etj.

Së teti, “disa iniciativa janë ndërmarrë nga shoqëria civile dhe bashkësitë fetare në Shqipëri, me qëllim parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Sidoqoftë, fokusi kryesor ka qenë luftimi dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe nuk janë zbatuar programe të prekshme për t’u marrë me individë apo grupe individësh, veprimet dhe thirrjet e të cilëve mund të konsiderohen të jenë radikale.”²⁹

Së nënti, edhe organizatat ndërkombëtare kanë kontribuar qëndrueshëm në këtë fushë. “Në vitin 2018 Prezenca e OSBE në Shqipëri ka mbështetur 5 kërkues të rinj të cilët janë angazhuar me punë kërkimore në tema të ndryshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Punimet e tyre u prezantuan në një konferencë në fillim të vitit.

Gjithashtu, në periudhën Tetor-Nëntor 2018, Prezenca e OSBE në Shqipëri nëpërmjet një eksperti lokal mbi çështje të ekstremizmit të dhunshëm ka organizuar workshope në 7 qytete që janë identifikuar më parë si hotspots/”pika të nxehta”. Në total, janë angazhuar mbi 140 të rinj në këto takime dhe vitin e ardhshëm do të vijohet të punohet me të rinjtë për nxitjen e mendimit kritik, zhvillimin e kapaciteteve për zgjidhjen e konflikteve personale dhe ç’mitizimin e fenomeneve negative që shpesh i bashkëngjiten diskutimeve me karakter fetar.

Përgjatë vitit 2018, OSBE ka mbështetur gjithashtu Qendrën e Koordinimit për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe së bashku kanë organizuar një takim kombëtar, në bashkëpunim edhe me UNODC³⁰, mbi identifikimin e luftëtarëve të huaj në kufi dhe ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve shqiptare në identifikimin e tyre dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal ndërmjet strukturave ligj zbatuese shqiptare dhe ato të vendeve fqinje.

Në trajnime 2 ditore të zhvilluara me anëtarë të Këshillave të Sigurisë në tre qytete të Shqipërisë, Prezenca nëpërmjet partnerit zbatues (Fondacionit për Autonomi dhe Qeverisje Vendore) ka ndihmuar në hartimin e Planeve të Veprimit për vitin 2019 ku janë përfshirë edhe masa për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm në këto qytete.

Në tetor të 2018, së bashku me Sekretariatit e OSBE në Vienë u bë prezantimi i manualit për rolin e shoqërisë civile në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm që mblodhi së bashku aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor për ndarjen e praktikave më të mira që kanë ndërmarrë këta aktorë në kundërshtimin e narrativave dhe EDH në përgjithësi.

²⁹ IDM & Berghof, Redion Qirjazi & Romario Shehu, “Perspektivat komunitare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri”, Rast Studimor 4, 2018, f. 28.

³⁰ <https://ëëë.unodc.org/southeasterneurope/en/albania.html>

OSBE gjithashtu po mbështet trajnimin e trajnerëve në një program 5 ditor në Shkup, ku tre të rinj nga qytete të ndryshme të Shqipërisë po marrin aftësitë e duhura për t'u bere peer to peer learners dhe liderë në komunitetet e tyre për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për vitin 2019, Prezenca e OSBE në Shqipëri do të vijojë mbështetjen e këtyre tre trajnuesve në aktivitete të ndryshme në nivel lokal.

Çdo vit, Prezenca gjithashtu mbështet zyrtarë publikë shqiptarë në konferencën mbarë evropiane kundër terrorizmit, ku pala shqiptare ka mundësi të prezantojë qasjen e saj në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm”.³¹

VI. Arritje dhe praktikat të mira

- Dalina Jashari, përfaqësuese e IDM, përmend si disa nga arritjet kryesore në këtë fushë: ndryshimet në Kodin Penal të RSH-së, Miratimin e Strategjisë Kombëtare KEDH, ngritjen e zyrës së Koordinatorit Kombëtar KEDH dhe ngritjen e një Qendre Koordinimi KEDH (Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 737, datë 13.12.2017), ndërmarrjen nga qeveria shqiptare të disa reformave institucionale, si për shembull: miratimi i praktikave të mira për P/LKEDH-në, rritja e kapaciteteve të trajnimit, si dhe atyre logjistike për Drejtorinë e Antiterrorit, përmirësimi i aftësive mbikëqyrëse dhe përmirësimi i koordinimit ndërmjet shërbimeve të inteligjencës dhe forcave të policisë; rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile, kryerja e vlerësimeve të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit nga grupe ekspertësh të pavarura në Shqipëri të cilat gjenerojnë sete të dhënash dhe rekomandime për vendimmarrësit dhe aktorë të tjerë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në nivel qendror dhe vendor;
- “KShH ka organizuar forume dhe trajnime me OSHC-të e ndryshme në të gjithë vendin, me qëllim rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të tyre rreth fenomenit të EDH. Me të njëjtin qëllim, KShH ka realizuar edhe 10 trajnime me stafin e burgjeve të sistemit penitenciar në Shqipëri. Gjithashtu me qëllim informimin e të rinjve rreth këtij fenomeni, KShH ka organizuar 8 forume me gjimnazistë të gjimnazeve të qyteteve të ndryshme.
- KShH në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) ka kontribuar edhe në përpilimin e Udhëzuesit “Për menaxhimin dhe parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm”, me qëllim unifikimin e praktikave të ndjekura nga stafi i burgjeve për trajtimin e rasteve potenciale të radikalizimit të të burgosurve, i cili është miratuar së fundmi nga DPB”.³²Pjesëmarrja e stafit të OSHC-ve në trajnime (ToT) në nivel kombëtar dhe rajonal, me qëllim rritjen e kapaciteteve, shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira ka përbërë një model pozitiv.

³¹ Informacioni i publikuar mbi rolin e Prezenca e OSBE në Shqipëri është marrë në rrugë zyrtare.

³² Informacion i marrë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)

VII. Cilat janë boshllëqet në lidhje me përfshirjen e OSHC-ve drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në çështje të parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm?

Në lidhje me OSHC-të që janë fokusuar specifikisht në parandalimin dhe luftimin e EDH , disa nga boshllëqet janë:

- Fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm është një fenomen i rrezikshëm dhe me ndjeshmëri të lartë, që ka marrë vëmendje më së shumti në vitet e fundit. Duke qenë një fenomen relativisht i ri për Shqipërinë, shoqëria shqiptare është e papërgatitur si duhet për tu përballur me të, në lidhje me përgjigjen institucionale, të burimeve njerëzore, burimeve financiare, mekanizmave të bashkëpunimit OSHC-institucione shtetërore dhe mekanizmave të bashkëpunimit OSHC-OSHC, etj.
- Një nga boshllëqet në lidhje me angazhimin e organizatave të shoqërisë civile në këtë fushë është mungesa e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore në stafet e tyre, kapaciteteve mbi monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të zbatuara në fushën e LKEDH dhe P/LKEDH, etj. Kapacitetet financiare të organizatave të shoqërisë civile që punojnë për të parandaluar dhe luftuar EDH dhe radikalizmin që çon në terrorizëm janë të kufizuara. Thirrjet për projekte të shpallura gjatë viteve të fundit për kontribut në këtë fushë kanë qenë përgjithësisht me afate relativisht të shkurtra dhe me mbështetje financiare të kufizuara.
- Programet e parandalimit të EDH nuk janë përshtatur mjaftueshëm, sipas nevojave të grupeve të synuara. “Veprimet e parandalimit duhet të jenë të përshtatura ndaj grupet specifike në rrezik. Në vend të qasjes “one size fits all”, veprimet parandaluese duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë e madhe të grupeve dhe drejtuesve të riskut.”³³
- Mundësitë financiare janë të kufizuara për të adresuar këtë fenomen në mënyrë të qëndrueshme. Projektet afatshkurtra të zbatuara nga organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri kanë pasur një kohëzgjatje mesatarisht disa muaj deri në një vit dhe në këto kushte nuk u krijojnë mundësi organizatave për qëndrueshmëri të rezultateve të arritura; Niveli i bashkërendimit të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë me autoritetet në nivelin vendor dhe qendror nuk është në nivelin e duhur. Mungojnë mekanizma të qëndrueshëm të këtij bashkëpunimi, përtej kuadrit të zbatimit të projekteve konkrete.

³³ Gjergji Vurmo & Enis Sulstarova, IDM, “Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri”, Një vlerësim kombëtar i shkaqeve, formave dhe kërcënimeve. Skuadra Hulumtuese e IDM: Gjergji Vurmo, Hulumtues Kryesor, Enis Sulstarova, Hulumtues, Aleka Papa, Hulumtues, Dalina Jashari, Hulumtues, Romario Shehu, Hulumtues. Tirana, Tetor 2018, f.12. Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Përforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm”, mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SHBA në Tiranë.
<http://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>

- Bashkëpunimi mes OSHC-ve dhe aktorëve në nivel vendor si përfaqësuesit e komuniteteve fetare, shërbimet sociale, institucionet e zbatimit të ligjit, shkollat, qeverisja vendore është vënë re se ka funksionuar më së shumti në nivel projektesh dhe jo si një qasje e qëndrueshme me një plan të qartë dhe afatgjatë.
- Hartimi dhe zbatimi i masave konkrete për mosangazhimin në veprimtari të EDH dhe ri-integrimit të këtyre si edhe shpërndarjen nga ideologjia ekstremiste e dhunshme e besimtarëve të tjerë fetarë “të manipuluar” konsiderohen me rrezikshmëri të lartë nga organizatat e shoqërisë civile. Edhe niveli i pamjaftueshëm i bashkëpunimit të organizatave të shoqërisë civile me pushtetin vendor vështirëson procesin e zbatimit të masave për ri-integrimit të individëve të kthyer, përveç të tjerash edhe përmes ofrimit të shërbimeve.
- Mungon mbështetja financiare nga shteti e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë. “Shumica e nismave për P/LKEDH-në janë zbatuar nga organizatat e shoqërisë civile me ndihmën e donacioneve nga donatorë të huaj. Donatorët orientohen nga qeveria, kryesisht nga Qendra e Koordinimit KEDH, për të orientuar mbështetjen financiare në këtë fushë, bazuar në nevojat që janë prezente.
- Është konstatuar rritja e numrit të të rinjve në iniciativat kundër EDH. Megjithatë, programet që fuqizojnë të rinjtë dhe udhëheqësit e tjerë të rinj duhet të kenë përhapje dhe promovim më të gjerë.³⁴
- Ndërsa konstatohet rritja e numrit të të rinjve në iniciativat informuese mbi fenomenin në nivel vendor, përfshirja e grave dhe rolit të tyre është e nevojshme të rritet. Kjo mund të realizohet përmes bashkëpunimit të ngushtë me organizatat që punojnë për të drejtat e grave dhe/ose rrejtet³⁵ që punojnë në këtë fushë. Përmes këtij bashkëpunimi mund të realizohet përfshirja e komponentit gjinor në çdo aktivitet apo iniciativë të ndërmarrë nga të gjithë aktorët, në mënyrë të veçantë Qendra e Koordinimit KEDH, e cila e konsideron si prioritet përfshirjen e komponentit gjinor.
- Media e shkruar dhe elektronike nuk përdoret sa duhet si mjet në nivel vendor dhe cilësia e përdorimit të medias si mjet ka nevojë të rritet si në median tradicionale ashtu edhe në median online, duke u fokusuar më shumë në rezultatet e iniciativave dhe ato progresive.
- Ndonëse bashkëpunimi i organizatave të shoqërisë civile me ekspertët dhe botën akademike është rritur, ende ka nevojë të punohet në këtë drejtim nga organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal dhe Universitetet në Tiranë dhe rrethe.

³⁴ Informacion i marrë nga IOM Albania.

³⁵ Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/>, Rrjeti AWEN;

- Nevojitet më shumë fokus në vlerësimin e projekteve dhe reflektimin mbi arritjet dhe sfidat. “Nuk është e lehtë të vlerësohet efikasiteti i këtyre programeve pasi ato janë të gjitha aktualisht në vazhdim. Për më tepër, këto programe janë kryesisht të përqendruara në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që përkthehet në rezultatet e projektit të pritsëm afatgjatë, duke e bërë impaktin afatshkurtër të vështirë për tu vlerësuar.”³⁶

a. Marrëdhënia midis organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisjes qendrore dhe vendore dhe sektorit privat në vend.

- Kanë rezultuar disa forma të bashkëpunimit të organizatave të shoqërisë civile me qeverisjen qendrore dhe vendore. Disa nga këto forma kanë qenë: Pjesëmarrje në aktivitetet e ndërsjella, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, lehtësimi në organizimin e aktiviteteve, mbështetje në adresimin e faktorëve kontribues dhe shtytës të ekstremizmit të dhunshëm, mbështetja e rasteve konkrete, etj.

- Bashkëpunimi i organizatave të shoqërisë civile me institucionet shtetërore kërkon të ri dimensionohet progresivisht. Ky bashkëpunim duhet të ndjekë zhvillimet në lidhje me numrin e identifikuar të individëve, luftëtarë terroristë në nivel kombëtar, numrin e të rikthyerve, numrin e individëve të riintegruar dhe monitorimin e rrezikut, në mënyrë të vazhdueshme. Qasja e autoriteteve për të bashkëpunuar me OSHC-të ka reflektuar edhe opinionin se çështjet e ekstremizmit janë domain i forcave ligj zbatuese apo shërbimit informativ dhe jo një çështje që i takon një numri të lartë të aktorëve në nivel vendor dhe qendror si dhe komunitetit në tërësi.

- Fusha e bashkëpunimit të organizatave të shoqërisë civile me autoritetet shtetërore në nivel qendror dhe vendor nevojitet të zgjerohet. Hapësirat e këtij bashkëpunimi nevojiten të forcohen në fusha si: Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me trajnimin e personelit në burgje, shërbimin e provës, psikologëve dhe/ose punonjësve sociale me qëllim trajtimin e duhur të të dënuarve dhe të paraburgosurve për vepra penale që lidhen me EDH dhe radikalizmin që çojnë në terrorizëm; bashkëpunimi me MB për iniciativa të ndryshme në zbatim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit në kuadrin e zbatimit të policimit në komunitet, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadrin edhe të përfshirjes së grave në këto iniciativa, në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, zbatimin e planeve të zhvillimit në nivel bashkie, qarku, etj.;

- Bashkëpunimi i OSHC-ve që punojnë në këtë fushë me sektorin privat është pothuajse jo ekzistent.

³⁶ IDM & Berghof Foundation, Redion Qirjazi & Romario Shehu, “Perspektivat e Komunitetit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri”, Rast Studimor 4, 2018, f. 28.

b. Cilat janë mekanizmat ekzistues për bashkëpunimin mes organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisë si edhe për bashkëpunimin OSHC-OSHC në vendin tonë?

Në lidhje me mekanizmat e bashkëpunimit të OSHC-ve me qeverinë, po listojmë disa prej tyre më poshtë:

- Policimi në komunitet përbën një mekanizëm shumë të rëndësishëm bashkëpunimi mes policisë dhe organizatave të shoqërisë civile për P/LKEDH/LKEDH dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm;

“OSHC-të mund të organizojnë fushata ndërgjegjësimi me qytetarët, për t’u shpjeguar se ç’është policimi në komunitet, cilat janë dobitë e tij dhe se si mund të përfitojnë ata. OSHC-të mund të ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre pozitive për policimin në komunitet në vendet e tjera, por edhe në vendin e tyre, në bashki dhe në qytete të ndryshme. OSHC-të mund të jenë edhe ndërmjetësuese apo të organizojnë konsultime ndërmjet qytetarëve dhe policisë, me qëllim nxitjen dhe forcimin e policimit në komunitet. OShC-të mund të jenë promotore të hartimit dhe përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore, të strategjive apo planeve të veprimit për policimin në komunitet, si dhe mund të bëjnë komente dhe sugjerime profesionale, kur këto akte hartohen me nismë të vetë institucioneve. Gjithashtu, OSHC-të mund të monitorojnë zbatimin e kornizës ligjore të policimit në komunitet, të zhvillojnë sondazhe me qytetarët për të matur ndjeshmërinë dhe vlerësimet e tyre mbi këtë policim dhe të llobojnë e advokojnë me institucionet shtetërore, me qëllim marrjen e masave që synojnë adresimin e problematikave të identifikuar³⁷. Bashkëpunimi i policisë me organizatat e shoqërisë civile në kuadrin e policimit në komunitet dhe drejtimit kryesorë të këtij bashkëpunimi janë trajtuar edhe në publikime të Prezencës së OSBE në Shqipëri³⁸.

- Ndarja e praktikave të mira dhe sfidave në aktivitete të përbashkëta në nivel kombëtar dhe rajonal, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverisjes qendrore, qeverisjes vendore dhe OShC-ve përbën një tjetër mekanizëm;

- Tërheqja e mendimit të OSHC-ve nga Qendra e Koordinimit KEDH, në lidhje me përgatitjen e strategjive, planeve të veprimit dhe zbatimit të tyre në të gjithë vendin është një mekanizëm i përdorur, i cili nevojitet të forcohet. Në këtë kuadër, Qendra e Koordinimit KEDH do të përdorë si platforma të hapura diskutimi rrjetet e saj, një ndër të cilat do të jetë rrjeti i OSHC-ve ku do të diskutohen/konsultohen politika/veprimtari, etj. Edhe rishikimi i politikave, planeve të veprimit, monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tyre përbën një mekanizëm të rëndësishëm në kuadrin e këtij bashkëpunimi.

³⁷ Izabela Kisic, Dushko Radosavleviq, Jarmila Bujak Stanko, Predrag Petroviq, Pavle Kilibarda, Pavel Domonji, “Ekstremizmi i dhunshëm sfida madhore e kohës sonë MANUAL PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE”, http://www.ahc.org.al/ep-content/uploads/2018/06/Manual_Ekstremizmit-1.pdf

³⁸ OSBE 2014, Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet, f.155, <https://www.osce.org/sq/secretariat/123186?doenloadçtrur>;

- Pjesëmarrja e OShC-ve në këshillat e sigurisë në disa bashki të vendit përbën një tjetër formë bashkëpunimi midis qeverisjes vendore dhe OSHC-ve. Ky përbën një nga mekanizmat që ndihmon qeverinë të shndërrojë politikat dhe planet e veprimit në rezultate konkrete në nivel vendor. “Organizatat e shoqërisë civile lokale janë shpesh më së miri të vendosura për të identifikuar prioritetet lokale dhe për të informuar politikëbërësit kombëtar dhe aktorët ndërkombëtarë mbi rreziqet të shoqëruara me përdorimin e terminologjisë së caktuar”³⁹. Bashkëpunimi i OSHC-ve me bashkinë, policinë, gjykatat e rretheve gjyqësore, prokuroritë e rretheve gjyqësore, komunitetet fetare, etj., në kuadrin e funksionimit të këshillave të sigurisë merr një rëndësi të veçantë.
- Nevojiten mekanizma më efektivë të këtij bashkëpunimi mes OSHC-ve dhe institucioneve vendore, me qëllim adresimin e rasteve të mundshme të ekstremizmit apo radikalizmit. Ndërkohë që punohet për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave efektivë në këtë fushë, mekanizmat ekzistues si Mekanizmi i Referimit Kundër Dhunës në Familje, Mekanizmi i Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel vendor mund të përdoren për parandalimin dhe luftën kundër EDH dhe radikalizmit që çon në terrorizëm.
- Thirrjet për projekte nga institucionet shtetërore ose institucionet në nivel vendor kanë munguar. “Një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare është “fuqizimi i shoqërisë civile në mënyrë që të krijojë qëndrueshmërinë e komunitetit”, por për këtë objektiv nuk është ndërmarrë asnjë masë e rëndësishme dhe nuk është bërë asnjë thirrje për projekte nga institucionet shtetërore për të mbështetur OSHC-të në zonat e synuara të pikave të nxehta, të përcaktuara në strategji. Në fakt, OSHC-të kanë qenë të varura nga grantet e huaja për zbatimin e projekteve për P/LKEDH-në”⁴⁰.
- Një strategji komunikimi krijuese dhe novatore do të krijonte më shumë mundësi për mekanizma mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor; “Megjithatë, është bërë shumë pak për angazhimin e aktorëve të ndryshëm, si zyrtarë shtetërorë, akademikë, media, shoqëria civile, komunitete fetare dhe punonjës socialë”⁴¹.
- Gjithashtu, kanë rezultuar mekanizma të bashkëpunimit midis OSHC-ve dhe institucioneve në nivel qendror, të cilat nevojiten të forcohen. Kështu, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë po zhvillon plane specifike implementimi për të gjithë elementët edukative të Strategjisë Kombëtare për të përfshirë programet e ndërgjgjësimit në shkollat e mesme, për të siguruar që të rinjtë janë të vetëdijshëm për çështjet dhe rreziqet e fenomenit në fjalë. Megjithatë, ekziston nevoja për t’u koordinuar më mirë midis agjencive kombëtare, komunave, shoqërisë civile dhe partnerëve të tjerë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe

³⁹ Eric Rosand, Emily Winterbotham, Michael Jones, Franziska Praxl-Tabuchi, A Roadmap to Progress, the state of the global P/CVE agenda, The Prevention Project and Royal United Services Institute, f.26, Shtator 2018;

⁴⁰ Pyetësori i plotësuar nga Dalina Jashari, IDM.

⁴¹ Pyetësori i plotësuar nga Dalina Jashari, IDM

koordinimit të aktiviteteve konkrete, për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm⁴².

c. Në lidhje me mekanizmat e bashkëpunimit OSHC-OSHC, disa prej tyre janë: ---

- Mekanizmat e subgrantimit kanë krijuar mundësi më të mëdha bashkëpunimi duke vendosur si kusht ose si preferencë zbatimin e projekteve në partneritet dhe zbatimin e projekteve nga një organizatë lokale si lider në projekt. "...donatorët gjithnjë e më shumë janë të gatshëm të mbështesin me burime nëpërmjet mekanizmave të financimit të sub-grantimit nga organizata më të mëdha, duke përfshirë këtu OSHC-të, të cilat mund të shpërndajnë grantet më shpejt dhe të mbikëqyrin (duke përfshirë raportimin dhe monitorimin tek donatorët, shpeshherë të vështirë) dhënien e shumave të vogla financimi tek aktorët në nivel lokal"⁴³.

- Kështu, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në kuadrin e projektit "Shoqëria civile në kundërshtim të ekstremizmit të dhunshëm", financuar nga Bashkimi Evropian ka mbështetur: 1.Qendra Rinore "Perspektiva", 2.Qendra UET, 3.Shoqata "Gruaja tek Gruaja", 4.Forumi Intelektual Mysliman Shqiptar, 5.Open Doors, 6.Qendra Agritra Vizion, 7.Instituti Shqiptar për Çështjet Publike, 8.Qendra për Progres Rinor, 9.Qendra Lëvizja Rinore për Demokraci, 10.Integrimi i Romëve të Veriut, 11. Unë Gruaja, 12.People in Focus, 13.Fondacioni Arsimor Shqiptar, 14. Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive, 15. Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, 16.Qendra "Integrim e Zhvillim Demokratik", Kukës, 17.Shoqata Gruaja në Zhvillim, Korçë, 18.Gruaja, Komuniteti, Mjedisi-Harmonizuar për Zhvillim, 19. Qendra e integritit Social dhe 20.Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara; Gjithashtu, Terre Des Hommes Albania në bashkëpunim me ISD, CCG dhe Universitetin Beder ka ofruar mbështetje për 21 organizata të shoqërisë civile në kuadrin e projektit "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Rritjen e Reziliencës së të Rinjve Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm", të financuar nga Bashkimi Evropian. USAID ka mbështetur iniciativë të ndryshme të shoqërisë civile, me synimin e zhvillimit të kapaciteteve dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit lokal.⁴⁴ Tryeza/Forume diskutimi me pjesëmarrje të gjerë të OSHC-ve që punojnë në mënyrë specifike ose relevante në këtë fushë, me qëllim që të koordinojnë aktivitetet e tyre në zbatim të strategjisë kombëtare kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

- Nuk kanë munguar mekanizma të prezantimit të projekt ideve nga organizatat aplikante për projekte, të cilat jo vetëm kanë rritur transparencën në sektorin e shoqërisë civile por kanë ndihmuar edhe përndarjen e praktikave të mira. Megjithatë, bashkëpunimi mes OSHC-ve që punojnë në këtë fushë është

⁴² Informacion i marrë nga IOM Albania.

⁴³ Eric Rosand, Emily Winterbotham, Michael Jones, Franziska Praxl-Tabuchi, A Roadmap to Progress, the state of the global P/CVE agenda, The Prevention Project and Royal United Services Institute, f. 20, Shtator 2018;

⁴⁴ Shih <http://www.mediationalb.org>

i kufizuar, nevojitet një komunikim më i qëndrueshëm mes tyre dhe rezultojnë në raste të caktuara mbivendosje në iniciativa, projekte, programe, raporte ose studime.⁴⁵

- Një zhvillim i rëndësishëm gjatë viteve të fundit ka qenë prioritizimi i mbështetjes për organizatat lokale në nivel komuniteti dhe drejtuesve lokalë që punojnë në këtë fushë. Ky prioritet nga njëra anë ka forcuar kapacitetet e organizatave lokale dhe nga ana tjetër ka nxitur nevojën për bashkëpunim të këtyre organizatave me organizata të tjerë me shumë eksperiencë, jo vetëm në fushë por edhe në lidhje me iniciativën e propozuar, menaxhimin e projekteve, etj.
- Krijimi i mundësive që në aktivitete të ndryshme OSHC-të grantmarrëse të ndajnë arritjet dhe sfidat e tyre si edhe mundësitë për bashkëpunim; Këto aktivitete organizohen me pjesëmarrjen jo vetëm të organizatave që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me P/LKEDH por edhe nga organizatat relevante. Përfshirja e stafit të OSHC-ve në trajnimet për trajnerë në nivel kombëtar dhe rajonal, me qëllimin e rritjes së kapaciteteve, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe eksperiencave;
- Lidhjet midis P/LKEDH dhe gjinisë janë duke u bërë gjithmonë dhe më të qarta dhe krijojnë më shumë mundësi për organizata që drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë kontribuojnë në parandalimin dhe luftën ndaj këtyre fenomeneve. “Programet e barazisë gjinore janë gjithnjë e më shumë aktivitete popullore për organizatat që operojnë në fushën parandaluese bazuar në supozimin se progresi në treguesit e fuqizimit më të gjerë gjinor mund të parandalojë radikalizmin që çon në dhunë”⁴⁶.
- Edhe lidhja me të drejtat e njeriut është më e qartë. Dhunimi i të drejtave të njeriut është një faktor kyç i EDH . Ky fakt kontribuon në bashkëpunimin më të fortë mes organizatave që punojnë drejtpërdrejtë me ato që punojnë në mënyrë të tërthortë në këtë fushë.

VIII. Cilat janë pengesat e bashkëpunimit mes OSHC-ve dhe qeverisë në kontributin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në P/LKEDH/LKEDH.

- Rezultojnë në praktikë mundësi të kufizuara për politikëbërësit për të dëgjuar dhe ndarë me OSHC-të arritjet, rezultatet e bashkëpunimit, sfidat, mësimet e nxjerra, pozitive dhe negative. Qëndrueshmëria e komunikimit mes tyre do të përkthehet në një bashkëpunim më të qartë dhe rezultativ. Rrjetëzimi i OSHC-ve do të ndihmonte në përmirësimin e këtij komunikimi. Nuk mungojnë

⁴⁵ Si p.sh në Çërrik), ku ka pasur një 'dyndje' të organizatave që kanë ndërhyrë aty, duke krijuar kështu një shtat stigmatizues për komunitetin.

⁴⁶ Eric Rosand, Emily Winterbotham, Michael Jones, Franziska Praxl-Tabuchi, “A Roadmap to Progress, the state of the global P/CVE agenda”, The Prevention Project and Royal United Services Institute, p.30, Shtator 2018;

- Pavarësisht kohëzgjatjes të zbatimit të projekteve dhe buxheteve në shuma modeste, organizatat e shoqërisë civile janë përpjekur të krijojnë qëndrueshmëri përmes organizimit të aktiviteteve të caktuara. Kështu, në kuadrin e punës me komunitetin në shkolla, organizatat kanë ndarë me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave materiale të ndryshme si manuale, raporte, guida, të cilat do të shërbejnë mësuesve dhe nxënësve me qëllim vazhdimin e punës për rritjen e ndërgjegjësimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm, edhe pas përfundimit të zbatimit të projektit; Aktivitetet peer to peer educators dhe Trajnimet për Trajnerë për të rinjtë kanë shërbyer gjithashtu për të ndarë informacionin me një numër sa më të madh individësh edhe pas përfundimit të zbatimit të projektit. Fuqizimi i aftësive të të rinjve nxënësve dhe studentëve përmes trajnimeve, me qëllim që ata të informojnë, fuqizojnë dhe mbështesin të rinj të tjerë bashkëmohatarë është përfshirë në disa nga projektet e organizatave të shoqërisë civile të mbështetura. Kështu, Qendra Rinore Pukë⁴⁸ ka zhvilluar aftësitë e 80 të rinjve të përzgjedhur nga shkollat e mesme të Pukës dhe Fushë Arrësit, në mënyrë që ata të shërbejnë si mentorë dhe mbështetës të bashkëmohatarëve, të rinjve të tjerë në rrezik 14-18 vjeç nga zonat rurale Pukë dhe Fushë Arrës, gjatë periudhës Janar 2017 - Prill 2018. Edhe në projektin e zbatuar nga Qendra “Gruaja Komuniteti Mjedisi, Harmonizuar për Zhvillim” në partneritet me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare gjatë vitit 2017-2018, janë fuqizuar kapacitetet e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, me qëllim që të ndajnë informacionin mbi P/LKEDH në zonën e Roskovecit. Këto kapacitete do të përdoren edhe pas përfundimit të projektit, nga organizatat lokale që punojnë në këtë zonë.

- Një nga aspektet pozitive është se, pavarësisht programit nëse është Program ndërhyrjeje, Program Parandalimi ose Program rehabilitimi, ka një larmishmëri të iniciativave dhe aktiviteteve brenda programit. Fokusi tematik i organizatave të shoqërisë civile është zgjeruar duke përfshirë tematika të ndryshme si: veprime konkrete të autoriteteve lokale, shkollave, familjeve, të rinjve për të punuar në trajtimin e faktorëve që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm, ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme, Pilotimi i Shkollës Qendër-Komunitare, Forcimi i Policimit në Komunitet, Rritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, Fuqizimi i partnerëve lokalë, Ekspertizë hulumtimi në nivel qendror dhe lokal, etj.

Përfaqësues të Organizatës Tjetër Vizion përmendin si disa nga pikat e forta të organizatave të shoqërisë civile arritjen e rezultateve si në vijim: Krijimi i këshillave të sigurisë në bashki të ndryshme si në bashkitë Gramsh, Prrenjas dhe Peqin, rritja e informacionit dhe kapaciteteve tek të rinjtë, krijimi i një rrjeti të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë dhe institucione kundër ekstremizmit të dhunshëm, hartimi i një strategjie dhe plani veprimi të përbashkët në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, mundësi të krijuara nga projektet për përgatitjen dhe ndarjen e botimeve të ndryshme në këtë fushë, hartimi i planeve të sigurisë në nivel bashkie si në bashkinë Elbasan, etj.

⁴⁸ <http://www.lrcd-albania.org/>

- Analiza e faktorëve që rrisin vulnerabilitetin përballë EDH dhe radikalizmit e bën më të qartë për OSHC-të fokusin e aktiviteteve dhe nismave që duhen ndërmarrë. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, individë të pakënaqur me jetën e tyre, individë të papërbushur janë identifikuar si potencialisht në rrezik për tu bërë pre e këtyre fenomeneve. Në këto kushte, fuqizimi ekonomik i familjeve dhe individëve, fuqizimi shoqëror i individëve, përbushja e tyre natyrshëm, forcimi i lidhjes individ-shtet dhe perceptimi nga individët i mbështetjes së shtetit përbëjnë drejtime të punës së organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse;
- Fokusi gjeografik i iniciativave është zgjeruar duke përfshirë rrethet Kukës, Dibër, Librazhd, Pogradec, Peqin, Cërrik, Tiranë, Korçë, Kavajë, etj. si edhe zona të caktuara rurale si ajo e Dorezit, Librazhd, fshatra të njësive administrative Kurjan, Kuman, në bashkinë Roskovec, etj.
- Disa organizata të shoqërisë civile kanë fituar një përvojë të pasur në këtë fushë përmes zbatimit të projekteve për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të qëndrueshme. Kështu IDM⁴⁹, KShH, ANTTARC, Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (ARCT), etj kanë zbatuar një numër projektesh në këtë fushë, duke forcuar edhe kapacitetet e stafëve të tyre.
- Janë krijuar organizata me përvojë si në zbatimin e projekteve me fokus të veçantë gjeografik, ashtu edhe me fokus kombëtar.
- Mjetet për përcjelljen e mesazheve kanë qenë të ndryshme. OSHC-të kanë përdorur strategji komunikimi, video sensibilizuese, artin, etj., me qëllim përcjelljen e mesazheve në grupet e synuara.
- Përfshirja e të rinjve dhe komunitetit si aktorë ndryshimi në programet e shoqërisë civile është rritur ndjeshëm.
- Njohja e rolit të grave si aktorë të ndryshimit në këtë fushë është rritur, pavarësisht nevojës për forcimin e këtij roli në nivel vendor;
- Zyra e Koordinatorit -KEDH ka qenë një pikë qendrore në bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile si edhe ka mbështetur në shkëmbimin e përvojave me to.
- Kështu, znj. Antonjeta Pero, Drejtoreshë Ekzekutive e Zyrës së Këshillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (ZKPAK) në Shkodër, vlerëson komunikimin dhe përvojën me 20 organizata vendore të mbështetura nga Komiteti Shqiptar

⁴⁹ Disa nga projektet që ka zbatuar IDM janë: Parandalimi i radikalizmit (me baza fetare) në Shqipëri, Fuqizimi i Partnerëve Lokalë në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, Forumi i Hulumtimit të Ekstremizmit në Ballkanin Perëndimor, Mundësi për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm përmes bashkëpunimit brenda dhe ndër-rajonat, Riforcimi i përpjekjeve dhe kapaciteteve për Parandalimin e EDH, Përtej kufijve të shkollës drejt komuniteteve të qëndrueshme, etj. Studimet e përgatitura nga IDM në vite përbëjnë një burim mjaft të rëndësishëm informacioni për të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë.

i Helsinkit (KShH), në implementimin e projektit “Shoqëria Civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”. Nuk ka munguar edhe bashkëpunimi i OSHC-ve me Qendrën Kombëtare KEDH Dhunshëm dhe përmes këtij bashkëpunimi është përfituar edhe nga përvojat e Zyrave përkatëse në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Hungari, Emiratet e Bashkuara, të cilat kanë ndarë informacion mbi fenomenin dhe përvojat për ta parandaluar atë.

b. Mundësitë

Axhenda globale në parandalimin dhe luftën kundër EDH ka ecur përpara në aspektin e numrit të programeve, institucioneve dhe fondeve në dispozicion për të mbështetur këto programe. Çështjet që lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit kanë qenë me interes të madh për donatorët vendas dhe të huaj, duke rritur numrin dhe larmishmërinë e aktiviteteve të OSHC-ve në këtë fushë. Për shkak të situatës globale, vende të tjera, veçanërisht vendet fqinje të Shqipërisë po organizojnë aktivitete të ngjashme. Një interes i tillë rajonal dhe sfidat e përbashkëta kanë krijuar mundësi për OSHC-të më me përvojë për të zbatuar projekte rajonale. Ambasada e SHBA-së në Tiranë ka mbështetur projekte që synojnë drejtpërdrejtë parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, si dhe projekteve, të cilat kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në adresimin e këtyre fenomeneve. Puna me studentët e universitetit si nxitës të ndryshimit, kryerja e studimeve dhe aktiviteteve që synojnë forcimin e komunitetit, fuqizimin e grave dhe të rinjve, iniciativat që kanë për qëllim forcimin e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), parandalimi i përhapjes së EDH në burgje etj., janë disa prej iniciativave të mbështetura nga ky partner i shoqërisë civile. “Më 30 Janar, Ambasadori Lu u takua me studentë nga Universitetet e Bedër, Logos dhe “Zoja e Këshillit të Mirë”, Instituti Teologjik Katolik në Shkodër dhe Akademia Ortodokse në Durrës në një diskutim të hapur”.⁵⁰ Gjithashtu, në fjalimin e saj në Konferencën “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”, E Ngarkuara me Punë, Zj. Moses-ones, vuri në dukje se: “Me ndihmën e më shumë se 5 milionë dollarësh të ndihmës amerikane, ne po punojmë me ju për të forcuar komunitetin, për fuqizimin e grave dhe rinisë, po përforcojmë qeverisjen lokale dhe nxisim zëra të moderuar brenda bashkësive fetare.”⁵¹ Programi “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm” dhe programet rehabilituese të zbatuara nga Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (ARCT), mbështeten nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta nën programin MATRA; Fondacioni Berghof mbështet Programin e Studimit të quajtur “Mundësitë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor”; Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS) gjithashtu ka ofruar mbështetje për iniciativat në këtë fushë. Këshilli i Evropës ka mbështetur disa iniciativa në këtë fushë, me qëllim gjetjen e mjeteve efektive kundër bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri, etj. Një mbështetës tjetër ka qenë Agjencia Austriake për Zhvillim.⁵²

⁵⁰ <https://al.usembassy.gov/sq/ambasadori-lu-bisedon-studente-universiteti-per-tolerancen-fetare/>

⁵¹ <https://al.usembassy.gov/sq/fjala-e-te-ngarkuares-me-pune-leyla-moses-ones-ne-konferencen-kombetare-ekstremizmi-i-dhunshem-ne-shqiperi>

⁵² Projekti “Luftimi i ekstremizmit fetar në media”, i zbatuar nga Instituti Shqiptar i Medias, mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim

- Sa i përket rrjetëzimit, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile deklarojnë se ata kanë përfituar nga një përvojë e tillë e rrjetëzimit në Rrjetin Lokal i P / LKEDH, Western Balkans Resonant Voice, etj.
- Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), po punon me synim ngritjen e shtatë rrjeteve që fokusohen në drejtimet e mëposhtme: 1) OSHC-të, 2) Media; 3) Hulumtime; 4) Rinia; 5) Besimi fetar; 6) Gratë; 7) Policimi në komunitet. Ngritja e këtyre rrjeteve do të jetë një kontribut i rëndësishëm në përpjekjet e përbashkëta në hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit si dhe zbatimin e tyre, duke krijuar mundësi për ato organizata të shoqërisë civile që synojnë të kontribuojnë në këtë fushë, përfshirë të rinjtë, gratë, organizatat fetare, etj.
- Përpjekjet janë bërë nga Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) për të krijuar një rrjet të dedikuar për OSHC-të, të cilat veprojnë në nivel kombëtar. Ky rrjet do të përdoret për të shkëmbyer informacion midis Qendrës së Koordinimit dhe OSHC-ve, i cili do të shërbejë për shmangien e mbivendosjes, për të marrë informacion nga OSHC-të që veprojnë në këtë fushë në nivel kombëtar, me qëllim përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe planeve të veprimit për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit;
- Zhvillimi i politikave dhe i planeve të veprimit përbën një mundësi për organizatat e shoqërisë civile. Çdo ministri po harton plane veprimi për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. Niveli i përfshirjes së OSHC-ve në hartimin e politikave dhe planeve të veprimit nuk ka qenë në pritshmëritë e kërkuara. Ky rol pritet të jetë irëndësishëm në fazën e zbatimit.
- Numri i donatorëve që mbështesin iniciativat e OSHC-ve në këtë fushë është në rritje, si Ambasada e SHBA-së në Tiranë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) mbështetur nga fondet e Komisionit European, Terre Des Hommes, etj të cilët përveç suportit financiar, janë edhe vetë zbatues të projekteve dhe iniciativave kundër EDH dhe radikalizmit.
- Organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal janë në një pozitë më të mirë aktualisht, sepse njohin kontekstin, territorin, grupet e marginalizuara dhe problemet që kanë të bëjnë me komunitetin. Besimi që ato kanë ndërtuar në nivel lokal është një mbështetës i rëndësishëm në përpjekjet e tyre në këtë fushë.
- Përvoja, informacioni, mekanizmat e bashkëpunimit me shtetin dhe OSHC-të, ndarja e praktikave më të mira, lidhjet e ngushta me komunitetin janë mjete që forcojnë organizatat e shoqërisë civile dhe qasjen e tyre ndaj këtyre fenomeneve.

- Nevojitet një angazhim më i madh nga institucionet lokale dhe grupet e tjera të interesit në nivel komuniteti për adresimin e fenomeneve të EDH dhe radikalizmit. Kjo është një mundësi e mirë për të bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile. Shtrirja e gjerë e faktorëve nxitës dhe tërheqës mundëson angazhimin e grupeve të interesit fetar, pushtetit vendor, OSHC-ve, qytetarëve etj.
- Universitetet, Akademia e Shkencave, Institutet Kërkimore, etj., janë një mundësi e mirë me të cilat duhet të forcohet bashkëpunimi i organizatave të shoqërisë civile.
- Komunikimi i rezultateve të punës së organizatave të shoqërisë civile me anë të një strategjie të qartë të komunikimit dhe një plani transparence dhe llogaridhënie është mundësi e mirë për të ndërtuar besimin e komunitetit në shoqërinë civile dhe për të rritur efektivitetin e partneritetit.

Analiza paraprake e dobësive, sfidave dhe pengesave me të cilat ballafaqohen OSHC -të lokale dhe grupet formale dhe joformale të komunitetit për zhvillimin e programeve P / LKEDH dhe çështje të lidhura me politikën.

a. Dobësitë

- Disa nga dobësitë lidhen me kuptime të paqarta të koncepteve bazë të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit, terrorizmit, etj. Ka boshllëqe në njohuri. Një tjetër barrierë e këtyre iniciativave është mungesa e trajnimeve të thelluara për stafet e organizatave ose trajnimeve me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, të cilat do të kishin ndihmuar në arritjen e rezultateve të pritshme. Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme të organizatave është domosdoshmëri. Edhe ndarja e mësimeve në lidhje me çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon në ngritjen e një reagimi kundër ekstremizmit të dhunshëm, reflektimi si ndihmon rrjetëzimi në nivel kombëtar dhe rajonal do të ndihmonin OSHC-të për të rritur kapacitetet e tyre.
- Nevojitet të rritet roli aktiv i organizatave të shoqërisë civile në lidhje me përgatitjen e politikave, planeve të veprimit në këtë fushë si edhe zbatimit të tyre, si në nivel qendror ashtu edhe lokal. Zbatimi i politikave dhe planeve të veprimit ekzistuese duhet të përcaktojë qartë partneritetet me shoqërinë civile, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të çdo partneri si edhe burimet përkatëse financiare dhe njerëzore
- Ndërsa rezulton se OSHC-të në nivel vendor janë të fokusuara në rritjen e ndërgjegjësimit mbi parandalimin dhe luftën ndaj këtyre fenomeneve, ndërgjegjësimi në nivel qendror ka nevojë të rritet.

- Roli i OSHC-ve për ofrimin e programeve specifike në menaxhimin e zemërimit, apo programe të tjera që adresojnë nevojat e një individi potencialisht në risk për përfshirjen në ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizëm nevojitet të forcohet. Këto nevoja mund të adresohen vetëm në bashkëpunim me aktorë të tjerë përgjegjës.
- Mungesa e eksperiencës së mëparshme të OSHC-ve në zbatimin e projekteve me fokus parandalimin dhe luftimin e EDH dhe radikalizmit ka përbërë një nga barrierat teknike të organizatave që kanë zbatuar projekte në këtë fushë. Nga intervistat, përfaqësuesit e organizatave grantmarrëse kanë ndarë se mungesa e eksperiencave të mëparshme u kishte marrë më shumë kohë dhe energji për arritjen e rezultateve.
- Fokusimi vetëm në disa zona dhe lënia jashtë vëmendjes së zonave të tjera që mund të kenë nevoja të barabarta. Ka pasur një përqendrim të aktiviteteve në mënyrë të veçantë në disa zona/qytete të caktuara, të cilat kanë qenë pjesë e raportimeve mediatike për raste të përsëritura rreth fenomenit në fjalë. Kjo gjë duket se ka lënë jashtë vëmendjes qytete dhe zona të tjera, të cilat janë pothuajse njësoj të ekspozuara përballë rrezikut të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Zbatimi i projekteve me buxhete të ulëta dhe që targetojnë fokus grupe shumë të vogla është një tjetër rezultat i analizës.

Përdorimi masiv i mediave sociale krijon mundësi për radikalët të komunikojnë qasje dhe mesazhe ekstremiste. “Mënyrat e reja dhe mjetet e komunikimit lejojnë radikalët të ndikojnë tek njerëzit emocionalisht (sidomos të rinjtë), t’i përfshijnë ata në veprimet e tyre, të promovojnë idetë, mesazhet dhe parimet e tyre. Komunikimi nëpërmjet celularit, multimedia, dhe teknologjia kompjuterike kanë transformuar komunikimin ndërpersonal në komunikim masiv, për shkak të të cilit radikalët kanë qasje në mijëra njerëz”.⁵³

- Identifikimi i personave që paraqesin probleme sa i takon fenomenit të ekstremizmit është një proces shumë i vështirë për organizatat e shoqërisë civile dhe në raste të caktuara me rrezik, si p.sh kur punohet me individë të radikalizuar, ose të dënuar për krime terroriste;
- Mungesa e një mekanizmi efektiv për menaxhimin e rasteve të identifikuara është një problem i mprehtë që kërkon qasje shumë disiplinare; Mekanizmat ekzistues si Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në familje në nivel vendor, Mekanizmi i Mbrojtjes së Fëmijëve, etj. mund të përdoren për adresimin e këtyre fenomeneve deri në ngritjen dhe funksionimin e plotë të mekanizmave të veçantë.

⁵³ Informacion nga pyetsori i plotësuar nga Qendra Rinore Pukë.

b. Sfida.

- Përfaqësues të OSHC-ve të intervistuar kanë identifikuar si një nga sfidat se tema mund të konsiderohet si paragjykuese ndaj feve të caktuara, nëse mungon niveli i duhur i specializimit të stafit që punon me iniciativa në këtë fushë.
- Duke qenë se shumë nga aktivitetet e OSHC-ve, në kuadrin e rritjes së ndërgjegjësimit, kanë qenë aktivitete në shkolla, një sfidë ka qenë bashkëpunimi i tyre me drejtoritë arsimore dhe institucionet e tjera arsimore. Kjo edhe për arsyen se OSHC të ndryshme paraqesin kërkesa për të punuar me komunitetin në shkolla, dhe në raste të caktuara në të njëjtat shkolla.
- Një nga sfidat e ndara nga organizatat e shoqërisë civile është mbingarkesa në menaxhimin e shumë aktiviteteve në një kohë të shkurtër dhe përpjekjet për shmangien e mbivendosjes së projekteve në këtë fushë.
- Një nga problematikat e ngritura është paralelizmi i gabuar i situatës së ekstremizmit të dhunshëm me origjinë fetare në BE, SHBA etj., me Shqipërinë apo edhe Ballkanin.
- Një nga sfidat për organizatat lokale ka qenë nevoja për forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e projekteve. Kjo sfidë është adresuar përmes bashkëpunimit të organizatave lokale me organizatat partnere dhe organizatat që i kanë mbështetur me grante, si në rastin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Terre Des Hommes, etj.
- Buxhetimi dhe kohëzgjatja e projekteve të zbatuara nga OSHC-të ka qenë e kufizuar duke mos krijuar mundësinë e iniciativave të qëndrueshme; Kjo kërkon një rol më aktiv nga organizatat e shoqërisë civile në nivel vendor me qëllim që iniciativat në këtë fushë të buxhetohen nga bashkitë, sektori privat apo aktorë të tjerë.
- Një nga barrierat me të cilat janë përballur organizatat e shoqërisë civile gjatë zbatimit të projekteve ka qenë edhe mungesa e besimit të duhur ndaj kontributit të shoqërisë civile në këtë fushë;
- Trajtimi i çështjes jo si një çështje e komuniteteve por si një çështje e sigurisë ka përbërë një sfidë gjatë punës së OSHC-ve për zbatimin e projekteve dhe iniciativave të ndryshme në këtë fushë. Garantimi edhe i sigurisë së stafit të organizatave të shoqërisë civile përbën një sfidë, e cila kërkon bashkëpunim të efektshëm me aktorët e tjerë në nivel vendor, si me drejtoritë vendore të policisë, komisaritet e policisë, etj.

- Monitorimi, vlerësimi dhe të mësuarit nga zbatimi i projekteve në këtë fushë ka përbërë një sfidë për organizatat e shoqërisë civile. Përcaktimi i një baseline dhe treguesve të mirëpërcaktuar është shumë i nevojshëm, me qëllim matjen e progresit

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteve
1.	Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, në të gjitha format dhe manifestimet e tyre; mbështetje në zbatimin e projekteve, hulumtim shkencor, trajnime, bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore; kundërshtimin e narrativave dhe ekstremizmit të dhunshëm.	Prezenca e OSBE në Shqipëri	Aktivitetet janë të organizuara në të gjithë vendin;	https://ëëë.osce.org/counter-ing-terrorism	Parandalimi dhe përballimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (VERLT).
2.	Angazhimi i komunitetit /Rritje e ndërgjegjësimit	Qendra për Progres Rinor (CYP)	Bashkia e Kukësit	http://cyp.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
3.	Angazhimi i komunitetit / identifikimi i hershëm dhe parandalimi / de-radikalizim	Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës (ARCT)	Territori i Shqipërisë	http://ëëë.arct.org/index.php	Programi i parandalimit
4.	Angazhimi i komunitetit / identifikimi i hershëm dhe parandalimi	Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive (INAC)	Rajoni i Elbasanit	ëëë.inac.org.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteteve
5.	Përfshirje e komunitetit, trajnime për mësuesit; hartimi i udhëzuesit për mësuesit në parandalimin e fenomeneve negative; aktivitete informale me përfaqesues të Bashkisë, komuniteteve fetare, shkolla, prindër, të rinjtë etj; studime “Vlerësimi i faktorëve nxitës dhe rekomandimeve për adresimin e fenomenit; Aktivitete jashtëshkollore, aktivitete ndërgjegjësuere.	Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (ALTRI)	Pogradec, Tiranë, Elbasan	ëëë.altri.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
6.	Rritja e ndërgjegjësimit/aktivitete informuese/hulumtim shkencor/hartim raporti	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)	Roskovec	http://ëëë.qag.al.org/ang/html/about.htm	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë/forcimi i komunitetit
7.	Përfshirje e komunitetit /trajnime	International Co – Operative Center Albania (ICC Albania)	Kombëtare dhe rajonale	ëëë.iccal.net	Programimi i parandalimit / Forcimi i komunitetit
8.	Rritja e ndërgjegjësimit/hulumtim shkencor//hartim raporti	Qendra “Gruaja, Komuniteti, Mjedisi - Harmonizuar për Zhvillim”	Roskovec	https://ëëë.facebook.com/GruajaKomunitetiMjedisi-harmonizuar-per-zhvillim-1678886732364471/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë/forcimi i komunitetit
9.	Rritje e ndërgjegjësimit, përgatitje pyetësorësh mbi fenomenin, organizim i ToT dhe forumeve rajonale,	Fondacioni Qendra Europiane	Tiranë, Elbasan, Pogradec	http://ëëë.euro-centre.eu/kreu/	Programi i parandalimit
10.	Rritja e ndërgjegjësimit /Trajnime	Qendra Këshillimore për Personat me Aftësi të Kufizuar Shkodër (ACPD)	Shkodra, Lezha, Kukësi	http://ëëë.qknjak.org/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteteve
11.	Rritja e ndërgjegjësimit/aktivitete ndërgjegjësuese	Forumi Intelktual Mysliman Shqiptar	Elbasan	ëëë.cveinfo.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
12.	Trajnime	Akademia e Studimeve Politike (ASP)	Kombëtare dhe ndër-kombëtare	ëëë.asp.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
13.	Përfshirje e komunitetit	Shoqata “Unë, Gruaja”	Bashkia e Pogradecit, Rrethi i Korçës	https://ëëë.unegruaja.org/ëhat-ëe-do/	Programi i parandalimit
14.	Rritje e ndërgjegjësimit	Qendra Shqiptare për Komunikim me Publikun (ACPC)	Paskuqan, Tiranë	ëëë.acpc.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
15.	Trajnime/mentorim	Partneriteti për Zhvillim Pozitiv - PDP	Pogradec	https://ëëë.facebook.com/pdporganisation/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
16.	Aktivitetet ndërgjegjësuese	Qendra “Agritra-Vision”	Rrethi Dibër	ëëë.agri-tra-vizion.com	Programimi i Parandalimit
17.	Trajnime, rritje kapacitetesh, aktivitete informuese, ri-integrim i luftëtarëve të rikthyer dhe familjet e tyre	IOM Albania	Territori i RSh	https://ëëë.albania.iom.int/	Programimi i Parandalimit / Qasja e gjithë shoqërisë/ Programimi i Rehabilitimit
18.	Trajnime/aktivitete ndërgjegjësuese	Qendra “Gruaja tek Gruaja”	Rrethi i Shkodrës; Bashkia Shkodër, Vau Dejes Bashkia e Bushatit dhe Barbullushit, dhe Bashkia e Malësisë së Madhe (Koplik dhe Hot).	ëëë.gruajatek-gruaja.com	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
19.	Aktivitete ndërgjegjësuese, pjesëmarrje në Këshillin e Sigurisë, trajnime	Qendra e Bashkëpunimit Ndër-fetar Elbasan	Prefektura e Elbasanit, Cërrik, Gramsh dhe Belsh.	ëëë.interreligiouscenter.com	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteteve
20.	Përfshirje dhe forcim i komunitetit, humlumtim, rritje kapacitetesh të aktorëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile, advokim	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM Albania)	Kukës, Dibër, Librazhd, Pogradec, Peqin, Cërrik, Tiranë, Korçë, Kavajë	http://idmalbania.org/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
21.	Përfshirje e komunitetit	CoDe Albania	Bashkia e Cërrikut	http://codealbania.org	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
22.	Aktivitete informuese/rritje e kapaciteteve	Qendra “Fëmijët Sot” (QFS)	Dorez, Librazhd	www.femijetsot.org	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
23.	Aktivitete informuese	Qendra “Tjetër Vizion”	Rrethi i Elbasanit (Prrenjas, Cërrik, Elbasan)	www.tjetervizion.org.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
24.	Forcim i komunitetit	Universiteti Bedër	Tiranë		Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
25.	Aktivitete informuese	Qendra Rinore Perspektiva	Dibra, Elbasani, Kukës	https://perspektiva4youth.org/	Programi i parandalimit
26.	Aktivitete informuese	Qendra UET	Elbasan		Programi i parandalimit
27.	Përfshirje e komunitetit	Qendra për Kërkime Sociale në Cilësinë e Shëndetit (QKSCSH)	Bashkia e Pogradecit, Rrethi i Korçës	https://www.qkscsh.org/?lang=en	Programi i parandalimit
28.	Aktivitete informuese	Open Doors	Elbasan		Programi i parandalimit
29.	Aktivitete informuese	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve	Pogradec, Tirane, Elbasan	http://observer.org.al/	Programi i parandalimit
30.	Aktivitete informuese	Instituti Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA)	Rajoni i Korçës	http://aipa.al/	Programi i parandalimit
31.	Forcimi i komunitetit	Shoqata për Integrimin e Komunitetit të Romëve të Veriut	Lezhë	https://www.facebook.com/Integrimi-i-Romëve-te-Veriut-584974618379876/	Programi i parandalimit

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteteve
32.	Trajnime, Aktivitete Ndërgjegjësuese, Matja e Perceptimit Qytetar mbi fenomenin/Raport	People in Focus Albania	Bashkia Has	https://www.facebook.com/peopleinfoocus/	Programi i parandalimit
33.	Hulumtim shkencor	Fondacioni Shqiptar i Arsimit	Shkodër	https://www.facebook.com/fashfanpage/	Forcimi i komunitetit
34.	Aktivitete informuese	Qendra Rinore Pukë	Bashkia e Pukës, Bashkia e Fusharrëzit Njësitë Administrative të Gjegjan dhe Qelez, Pukë	https://www.facebook.com/levizjarinore.puke.5	Qasja e gjithë shoqërisë / forcimi i komunitetit
35.	Trajnime/aktivitete informuese/hulumtim akademik	Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIS)	Kombëtar dhe rajonal	www.aais-albania.org	Qasja e gjithë shoqërisë / forcimi i komunitetit
36.	Aktivitete ,trajnime dhe fushata ndërgjegjësuese ;hulumtuese dhe informuese	Organizata "Woman Center for Development and Culture"	Kombëtare dhe rajonale	https://www.cdc.al/	Programi i ndërgjegjësimit dhe parandalimit/ Rritje e kapaciteteve dhe narrativave kundërshtuese/ qasja e të gjithë shoqërisë dhe forcimi i komunitetit
37.	Promovimi i Strategjisë Kombëtare në Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	YMCA Tirana, Albania	Kashar (Yzberisht, Mëzez, Kaktund i Ri)	www.ymcatirana.al/wordpress.com	Programi i parandalimit / forcimi i komunitetit
38.	Aktivitete informuese me të rinjtë/ forcimi i komunitetit	Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim - RIAS	Pogradec	https://www.facebook.com/pg/RIASorganization/about/?ref=page_internal	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
39.	Aktivitete informuese me të rinjtë/ forcimi i komunitetit	Bordi Rinor Këshillimor Pogradec	Pogradec	https://www.brkp.al/wordpress.com/about/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
40.	Trajnime/aktivitete informuese/ forcimi i komunitetit/hulumtim shkencor/advokim/sub-grantim, hartim udhëzuesi	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)	Territori i Shqipërisë	http://www.ahc.org.al/?lang=en	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteteve
41.	Ofrim mbështetjeje nëpërmjet skemës së granteve	Ambasada e SHBA në Shqipëri	Territori i Shqipërisë	https://al.usembassy.gov/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
42.	Trajnime/aktivitete informuese/ forcimi i komunitetit/hulumtim shkencor/advokim/mbështetje nëpërmjet sub-grantimit	Terre des Hommes Albania	Territori i Shqipërisë	https://ëëë.tdh.ch/en	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
43.	Aktivitete informuese me shkollat/ Trajnime/Forcimi i komunitetit	Instituti Europian Pashko	Kamëz, Tiranë	http://ëëë.pashkoinstitute.org/about-us/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
44.	Trajnime me anëtare të Këshillave të Sigurisë;Hartimi i Planeve të Veprimit për vitin 2019	Fondacioni për Autonomi dhe Qeverisje Vendore (FLAG)	Cërrik, Elbasan dhe Librazhd	http://flag-al.org/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
45.	Aktivitete informuese me shkolla	Shoqata "Gruaja në Zhvillim Korçë"	Korça	https://gzhk.org/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
46.	Aktivitete ndërgjegjësuere/informuese	Qendra për Integrim dhe Zhvillim Demokratik Kukës - DIDCK	Kukës, Has	-	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë
47.	Aktivitete ndërgjegjësuere/informuese	<u>ANTTARC</u>	Territori i Shqipërisë	http://anttarc.org/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë/forcimi i komunitetit
48.	Trajnime/aktivitete ndërgjegjësuere/ krijimi i një Këshilli Lokal për Siguri Publike	GUS Albania	Territori i Shqipërisë	https://gusalbania.al/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë / forcimi i komunitetit
49.	Trajnime/aktivitete informuese/ forcimi i komunitetit/hulumtim shkencor/advokim/sub-grantim	Shoqata "Together for Life"	Territori i Shqipërisë	http://togetherforlife.org.al/sq/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
50.	Aktivitete informuese me shkollat/ Forcimi i komunitetit	Shoqata Internacionale për Solidaritetin (SHIS)	Kombinat	http://ëëë.shisalbania.org/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit

Nr.	Tematika	Emri i OShC / OBF	Fokusi Gjeografik	Faqja zyrtare	Lloji i fokusit të aktiviteteve
51.	Aktivitete informuese	Infinet +	I gjithë territori i Shqipërisë	http://infinetplu-si.com/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
52	Promovimi i punësimit të të rinjve dhe sipërmarrjes, përgatitja e një plani lokal për punësimin e të rinjve; organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere	Qendra e Integritimit Social	Elbasan	https://ëëë.facebook.com/Qendra-e-Integritimit-Social-261268837607959/?tn-strçk*F	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
53	Rehabilitim i luftëtarëve të rikthyer nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përjavshme me karakter fetar në burgje	Qendra për Korrektim Njerëzor (KRNJ)	I gjithë territori i Shqipërisë		Programi i rehabilitimit
54	Aktivitete ndërgjegjësuere, trajnime me komunitetin mbi P/LKEDH/LKEDH	Në Familje për Familjen	Cërrik dhe Belsh	ëëënpf.org.al	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit
55	Aktivitete ndërgjegjësuere, trajnime, ëorkshope për rritje kapacitetesh, hulumtim dhe përgatitje raporti mbi faktorët shtytës dhe tërheqës së P/LKEDH/LKEDH	Qendra Focus	Tirana dhe Pogradec	https://ëëë.facebook.com/qendraFokus/	Programi i parandalimit / qasja e gjithë shoqërisë /forcimi i komunitetit

ANEKS II

Përkufizime

Duke pasur parasysh se terminologjia rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimi dhe kundërshtimi mund të jetë konfuzë dhe problematike - terminologjia shpesh politizohen dhe përdoren në mënyrë të ndërsjellë dhe shpesh pa përkufizim të qartë, duke rezultuar me të njëjtat terma që përdoren për të përshkruar qasje të ndryshme - për qëllimet e këtij hartimi, u përdorën përkufizimet e hartuara nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal si pjesë e Platformës së saj Rajonale për Kundërvajtjen e Radikalizimit dhe EDH për Terrorizmin dhe Rekrutimin e Luftëtarëve të Huaj:

i. ekstremizmi i dhunshëm (EDH): Emri për fenomenin ku njerëzit ose grupet, në ndjekje të qëllimit të tyre ideologjik, shfaqin gatishmërinë për të përdorur dhunën si pasojë përfundimtare të mënyrës së tyre ekstremiste të të menduarit; përdorimi i dhunës për të ndjekur qëllimet politike; procesin e marrjes së pikëpamjeve ekstremiste / radikale (politike, fetare ose ideologjike) dhe vënien e tyre në veprim të dhunshëm.

ii. parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm (P / LKEDH): Përdorimi i mjeteve jo detyruese që kërkojnë të adresojnë shoferët ose shkaqet rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm. Sipas PNUD, “një dallim zakonisht mund të nxirret mes P/LKEDH (Parandalimit dhe Luftimit të Ekstremizmit të Dhunshëm), e cila është e fokusuar në kundërshtimin e aktiviteteve të ekstremistëve ekzistues të dhunshëm dhe LKEDH (Luftimine Ekstremizmit të Dhunshëm), e cila është e fokusuar në parandalimin e përhapjes së mëtejshme të ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, në praktikë, iniciativat shpesh do të punojnë në të dyja aspektet, me një qasje të kombinuar. “Ky hartim duhet të përfshijë OShC-të, ndër të tjera, duke punuar në projekte që janë etiketuar ose përshkruar ndryshe si” CVE “,” PVE “ose” P / CVE “.

Përkufizime shtesë relevante:

Specifike për P / LKEDH: OSHC-të e renditura në raportin rrjetëzues duhet të klasifikohen si specifike për P / LKEDH në rastet kur angazhohen në aktivitetet e mëposhtme: parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm, deradifikimi, zhbllokimi dhe riintegrimi, narrativi dhe mesazhet e kundërta, rritja e qëndrueshmërisë dhe forcimi i komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitete të tilla janë të dizajnuara me qëllimin e qartë të reduktimit ose ndërtimit të nivelit të qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

De-radikalizimi: procesi social dhe psikologjik ku angazhimi dhe përfshirja e një një individi në ekstremizëm të dhunshëm zvogëlohet në masën që ata nuk janë më në rrezik të përfshirjes dhe angazhimit në veprimtari të dhunshme, pra refuzimi

i ideologjisë së dhunshme ose besimit dhe angazhimit për të përdorur dhunën për ta avancuar atë. De-radikalizimi gjithashtu mund t'i referohet çdo iniciative që përpiket të arrijë një zvogëlim të rrezikut të rikthimit nëpërmjet adresimit të çështjeve specifike dhe relevante të mosangazhimit. De-radikalizimi nënkupton një ndryshim të ndryshëm nga ai që lidhet vetëm me përjashtimin: nënkupton ndryshimin në një nivel njohës, jo thjesht ndërprerjen fizike të disa sjelljeve të vëzhgueshme.

Mos-angazhimi: procesi në të cilin një individ përjeton një ndryshim në rolin apo funksionin që zakonisht shoqërohet me një reduktim të pjesëmarrjes së dhunshme - domethënë, mohimin e akteve të dhunshme më shumë sesa ideologjinë apo besimet themelore. Kjo mund të mos përfshijë domosdoshmërisht largimin nga organizimi apo lëvizja e ekstremizmit të dhunshëm. Përveç kësaj, mos-angazhimi i plotë mund të vijë nga ndryshimi i rolit, që ky i fundit mund të ndikohet nga faktorë psikologjikë, si zhgënjimi, shpërthimi ose dështimi për të arritur pritjet që ndikuan në përfshirjen fillestare. Kjo mund të çojë te një anëtar që kërkon një rol ose role të ndryshme brenda lëvizjes.

Ri-integrimi: Procesi në të cilin një rikthim i “luftëtarit të huaj terrorist” (LHT) ose ish-ekstremist i dhunshëm i cili konsiderohet se nuk paraqet kërcënim për sigurinë, sigurohet mbështetje psiko-sociale, arsim, punësim ose trajnim për të lehtësuar ri-hyrjen e tyre në komunitet nga e cila kanë origjinën ose një komunitet tjetër të përshtatshëm.

Mesazhe kundër-narrative: mesazhe që ofrojnë një pamje alternative ndaj rekrutimit dhe propagandës ekstremiste. Mesazhimi mund të japë një përgjigje alternative ose rrugën për të rekrutuarit potencialë të cilët mund të kërkojnë udhëzime ose kuptime. Mesazhet kundër-narrative mund të kërkojnë gjithashtu të dekonstruktojnë narrativat ekstremiste dhe të ekspozojnë gabime logjike.

Forcimi i komunitetit: aftësia e një komuniteti për t'i bërë ballë, për t'u përgjigjur dhe për t'u rimëkëmbur nga një gamë e gjerë ngjarjesh të dëmshme dhe të padëshirueshme. [Shënim: varësisht nga dizajni / synimi i një programi të “forcimit të komunitetit”, këto përpjekje mund të kategorizohen si specifike për P / LKEDH ose relevante për P / LKEDH]

Relevante për P / LKEDH: OSHC-të e renditura në raportin e rrjetëzimit klasifikohen si relevante për P / LKEDH kur angazhohen në aktivitete që në mënyrë indirekte adresojnë nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet: fuqizimit të të rinjve dhe grave, sundimit të ligjit, antikorrupsionit, angazhimit qytetar, të drejtat, demokracinë, qeverisjen e mirë, formimin profesional, arsimin, ndërtimin e besimit dhe angazhimit të komunitetit, si dhe zgjidhjen e konflikteve. Qëllimi i aktiviteteve të OShC-ve relevante për P / LKEDH nuk është të parandalojnë apo të luftojnë ekstremizmin e dhunshëm, por që megjithatë kontribuojnë në reduktimin ose ndërtimin e forcimit të komunitetit kundër ekstremizmit të dhunshëm.

RRETH PROJEKTIT

Komunitetet e parat është një platformë rajonale e shoqëricë civile për Ballkanin Perëndimor për P / LKEDH, udhëhequr nga konsorciumi i gjashtë organizatave jo-qeveritare nga Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Serbia. Kjo iniciativë tre-vjeçare është përqendruar në nxitjen e bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal midis OShC-ve në nivel lokal, organizatave me bazë fetare dhe aktivistëve të komunitetit të angazhuar në P / LKEDH. Qëllimi i programit është fuqizimi i këtyre aktorëve, rritja e kapaciteteve të tyre, përmirësimi i efikasitetit dhe llogaridhënia, dhe mundësimi i tyre për të qenë ndikues më efektivë në politikave përkatëse të P / LKEDH.

Aktivitetet përfshijnë: hartimin e programeve dhe iniciativave të P / LKEDH të udhëhequr nga OShC; zhvillimin e rrjetit online së OShC-ve për ndarjen e praktikave të mira, burimeve dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal; programet e ndërtimit të kapaciteteve dhe mentorimit; dhe krijimin dhe zbatimin e programit të granteve të vogla.

RRETH QENDRËS PËR NISMA LIGJORE QYTETARE (QNL)

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) është një organizatë jo-qeveritare shqiptare, me seli në Tiranë, e themeluar që në Nëntor të vitit 1997. QNL funksionon si një qendër që ofron shërbime juridike për grupet vulnerabël, duke u fokusuar veçanërisht tek gratë që janë viktime të dhunës në familje dhe / ose viktime të diskriminimit gjinor, me qëllim rritjen e aksesit së tyre në sistemin shqiptar të drejtësisë. Të gjitha shërbimet ofrohen FALAS.

